



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



Basic Education Program



VLERËSIMI FORMATIV

Si do ta di
nëse kam mësuar?
Vlerësim
Informate kthyesë
Reflektim
Vetëvlerësim
Pa duar lart
Publikat
Ngjyrat e
semaforit
Kriteret e suksesit
Reflektim
Informate
kthyesë
Vetëvlerësim
Informate
kthyesë



Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk i reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Doracaku është financuar nga populli amerikan përmes Agjencionit të SHBA-së për zhvillim ndërkombëtar (USAID Kosovë), në kuadër të Programit për arsimin themelor (Basic Education Program të USAID-it) të cilin e zbaton Family Health International (FHI 360) në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës (MASHT).



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



Basic Education Program

VLERËSIMI FORMATIV

HARTUAR NGA

Dr. Damian Murchan

Dr. Gerry Shiel

Dr. Eda Vula

Arlinda Gashi Bajgora

Vllaznim Balidemaj

Recensentë

Lindita Bllaca

Besa Zeqiri

Milazim Avdylaj

Lektor

Anyla Zajmi

DIZAJNI GRAFIK

indesign

BOTIMI I DYTË

Shkurt, 2013

FALËNDERIME:

Basic Education Program (Programi i Arsimit Themelor) u shprehë falenderime të singerta të gjithë atyre që kontribuan në realizimin e këtij doracak. Falenderime të veçanta, Divizionit për Vlerësime, Standarde dhe Monitorim, MASHT; shkollave prijëse të vlerësimit që pasuruan doracakun me shembuj dhe fotografi; drejtorëve të shkollave prijëse për një bashkëpunim të shkëlqyeshëm si dhe nxënësve të shkollave për shembujt e ofruar.

Shkollat prijëse të Vlerësimit: "Hilmi Rakovica", Prishtinë; "Dardania", Prishtinë; "Abdullah Shabani", Mitrovicë; "Beqir Gashi" Malishevë; "Yll Morina", Gjakovë; "Asdreni", Pejë, "Selami Hallaqi", Gjilan; "Vëllezrit Frashëri", Lipjan; "Vezir Jashari", Ferizaj; "Ismet Rraci", Klinë; "Abdyl Frashëri", Prizren.

PËRMBAJTJA

Mirësevini	6
Si mund të ju ndihmojë ky doracak?	7
Si ta përdorim doracakun?	8
Legjenda	8
1. Pse duhet ta ndryshojmë vlerësimin në klasë?	9
Krahësim në mes të vlerësimit tradicional dhe vlerësimit të shekullit 21.....	11
Ngritja profesionale e mësimitdhënësve për Vlerësimin për Nxënie	14
2. Përkufizime për vlerësimin dhe llojet e vlerësimit	15
Ç'është vlerësimi?	15
Vlerësimi në klasë - llojet	16
Roli i mësimitdhënësve, nxënësve, drejtorëve dhe prindërve në Vlerësimin për Nxënie	20
Parimet e Vlerësimit për Nxënie - VpN	24
3. Zbatimi i strategjive për Vlerësimin për Nxënie	25
Karakteristikat e Vlerësimit për nxënie	26
3.1 Qëllimet e të Nxënit	28
3.2 Kriteret e Suksesit	29
3.3 Informata kthyesë	39
3.4 Vlerësimi i Ndërsjellë (njëri-tjetri)	44
3.5 Vetëvlerësimi	47
3.6 Përdorimi i strategjive efektive të parashtrimit të pyetjeve	53
4. Vlerësimi si komponentë e planifikimit të mësimit	59
4.1 Planifikimi i orës mësimore dhe integrimi i VpN-së	59
4.2 Rezultatet e të nxënit dhe vlerësimi i bazuar në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës	61
Fjalorth i nocioneve të doracakut	63
Literatura e shfrytëzuar dhe burime tjera	65

Mirësevini

Të nderuar mësimdhënës

Edukatorët (Mësimdhënësit), nxënësit dhe prindërit që të gjithë kanë një vizion të përbashkët të një sistemi arsimor në Kosovë, ku nxënësit i zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë dhe prirjet e ngjashme dhe të krahasueshme me ato të nxënësve në vendet tjera. Qëllimi i këtij doracaku është që t'iu ndihmojë juve si mësimdhënës për ta bërë këtë vizion një realitet për nxënësit tuaj.


Hulumtimet kanë treguar se një pako mjaft e thjeshtë e strategjive mund ta përmirësojë rrënjësisht të nxënësve. Këto strategji përfshijnë: qëllimet e përbashkëta të orës së mësimt me nxënësit; ofrimin e një modeli të mirë të asaj se si duket suksesi; ofrimin e informatave kthyesë në formë komentesh përkrahëse, e jo në formë notimi; dhe inkurajimin e nxënësve për ta vlerësuar përparimin e vet dhe për ta planifikuar vet të nxënësve të tyre. Kjo qasje është e njohur si *vlerësimi për nxënie*.

Arsyeja kryesore përse kjo qasje është efiçase është sepse u ndihmon nxënësve dhe mësimdhënësve të tyre që të zhvillojnë një kuptim vërtetë të mirë rreth asaj se ku gjenden ata në procesin e të nxënësve të tyre, ku duhet të arrijnë dhe si të arrijnë atje më së miri.

Ky doracak do t'iu ndihmojë për t'i zhvilluar njohuritë tuaja dhe të kuptuarit rreth *vlerësimit për nxënie* dhe do t'iu ndihmojë në zbatimin e *vlerësimit për nxënie* në orët tuaja të mësimt. Ai do t'ju udhëzojë, me shembuj, se si duhet mbledhur informatat në lidhje me përparimin dhe arritjet e nxënësve, se si t'i përdorni këto informata për ta pasuruar mësimdhënien dhe të nxënësve, dhe si t'ua raportoni këto informata të gjithë atyre që merren me fushën e arsimit.



Si mund të ju ndihmojë ky doracak?



Trajnimi i mësimdhënësve mbështetet në zbatimin e Standardeve për Vlerësim dhe Kodin e Etikës për vlerësim, që janë zhvilluar në bashkëpunim me MASHT-in në kuadër të këtij projekti.

Doracaku përmban materiale të trajnimit të përgatitura nga konsulentët e projektit, Damian Murchan, Gerry Shiel, Eda Vula, Arlinda Gashi Bajgora dhe Vllaznim Balidemaj. Në doracak janë përfshirë edhe materiale tjera që kanë të bëjnë me çështje të caktuara të lidhura me Vlerësimin për nxënie, të bazuara në aktivitetet e mësimdhënësve që ishin pjesëmarrës në pilotimin e projektit '**Përmirësimi i vlerësimit të rezultateve të të nxënit**'.


Doracaku është i dedikuar që të përdoret gjatë trajnimeve të mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave të Kosovës me qëllim që ata të familjarizohen me strategjitë e ndryshme të Vlerësimit për nxënie (Vlerësimi Formativ). Poashtu, doracaku mund të përdoret edhe si pjesë përbërëse e aktiviteteve të rregullta dhe të përditshme në klasë. Ai është hartuar për t'iu mundësuar mësimdhënësve, stafit udhëheqës të shkollës dhe edukatorëve në përgjithësi që të punojnë së bashku për shfrytëzimin e vlerësimit në klasë, si 'mjet' për ta ndihmuar të nxënit për të gjithë nxënësit.

Nga ky doracak ju do të:

- *Dalloni Vlerësimin për Nxënie (VpN) dhe Vlerësimin e të Nxënit (ViN);*
- *Zotëroni njohuri dhe shkathtësi të reja për procesin e zbatimit të procedurave të ndryshme të vlerësimit;*
- *Zbatoni strategji të shumëllojshme të Vlerësimit për nxënie në mësimdhënien e përditshme; dhe*
- *Promovoni VpN në shkollën/klasën tuaj*



Si ta përdorim doracakun?



Doracaku përmban aspekte teorike të lidhura me Vlerësimin për Nxënie të cilat gërshetohen me probleme praktike dhe aktivitete për mësimdhënie. Kjo e bënë doracakun të jetë lehtë i përdorshëm dhe shumë praktik jo vetëm për fasilituesit por edhe për vetë pjesëmarrësit/mësimdhënësit.

Fillimisht janë dhënë disa informata të përgjithshme për nevojën e ndryshimeve në sistemin tonë të arsimit, të cilat domosdoshmërisht janë të lidhura me zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe bashkëpunimin e tyre me stafin udhëheqës të shkollës.





Në Kapitullin e dytë janë dhënë përkufizime për Vlerësimin për Nxënie (Vlerësimin Formativ) dhe Vlerësimin e të Nxënit (Vlerësimin Sumativ) si dhe është bërë i qartë raporti ndërmjet këtyre koncepteve. Natyra e këtij trajnimi është e tillë që mësimdhënësit angazhohen drejtpërdrejtë në marrjen e njohurive të reja dhe zbatimin praktik të tyre. Kështu, angazhimi i tyre në mënyrë individuale, në çifte dhe në grupe do të jetë pjesë përbërëse e aktiviteteve të planifikuara në këtë doracak.

Kapitulli i tretë i shqyrton në mënyrë të detajuar karakteristikat kryesore të Vlerësimit për nxënie (VpN), si dhe rëndësi e veçantë i kushtohet strategjive për zbatimin e VpN-së në klasa. Pjesëmarrësit gjatë trajnimit do të kenë mundësi të përfshihen në aktivitete të shumta praktike që e mundësojnë përfshirjen e VpN-së si komponentë të mësimdhënies së tyre të përditshme.

Një prej sfidave që garanton cilësi të mësimdhënies dhe të nxënit është padyshim planifikimi i orës mësimore. Integrimi i VpN-së në planet e përditshme të mësimdhënësve është shqyrtuar në Kapitullin e katërt. Pjesë shtesë e këtij doracaku janë shtojcat, të cilat do të përdoren gjatë trajnimit dhe në të cilat janë dhënë jo vetëm informacione të rëndësishme që ndihmojnë mësimdhënësit të zhvillojnë planifikime të aktiviteteve (me bazë në Vlerësimin për Nxënie), por ato i përshkruajnë në mënyrë të detajuar hapat që pjesëmarrësit duhet t'i ndjekin me qëllim të përmbushjes së objektivave të trajnimit.

Në doracak janë përdorë 'shënime' të ndryshme të cilat kanë për qëllim ta mbajnë mësimdhënësin të fokusuar në disa çështje me interes të veçantë. Meqë hartimi i këtij doracaku është bazuar në Standardet e Vlerësimit të MASHT-it në shumicën e rasteve është bërë një lidhje e atyre standardeve me aktivitetet praktike të paraqitura në të. Për ta lehtësuar punën e fasilituesve pjesëmarrësve dhe lexuesve, janë shfrytëzuar 'kutizat' me ngjyra dhe forma të ndryshme të cilat përmbajnë informacione të veçanta.

Legjenda

	Shembuj konkret apo tregime nga shkolla
	Aktivitetet në klasë
	Më rëndësi të madhe
	"Standardet e Vlerësimit"
	informacione që rrjedhin nga hulumtimet, vegëzat, etj.




1. Pse duhet ta ndryshojmë vlerësimin në klasë?

Ndryshimet në shoqëri bëjnë që edhe mësime të përballesh me detyra të reja në klasat e tyre. Ata ballafaqohen me mënyra të ndryshme të mësimit dhe detyra të cilat duhet t'u përshtaten nxënësve dhe mënyrës se si mësojnë ata, edhe pse nuk janë të sigurt se cilat ndryshime tjera i presin në të ardhmen. Gjatë dekadave të fundit, ndryshimet politike, sociale, ekonomike dhe ato mjedisore, e po ashtu edhe zhvillimi i shkencës dhe teknologjisë kanë bërë që çdo aspekt i lidhur me shkollën të shqyrtohet dhe të rishikohet, duke përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve.

Deri vonë, vlerësimi në klasë është konsideruar si një mekanizëm për sigurimin e një indeksi të nxënies, i cili ka marrë për bazë një model të parashikuar: mësime të japin mësime, i testojnë njohuritë e nxënësve për përmbajtje të caktuara, gjykojnë për arritjet e tyre bazuar në ato 'testime' dhe më pas vazhdojnë me njësi të reja. Kjo mënyrë e vlerësimit sot është vënë në pikëpyetje sepse pritjet shoqërore për arsimin sot kanë ndryshuar, shkencat kognitive kanë dhënë rezultate të reja për natyrën e të nxënësve, dhe roli tradicional i vlerësimit për motivimin e të nxënësve tashmë është sfiduar. Me qëllim të përgatitjes së nxënësve për shkollën e shekullit 21 është e nevojshme që të përdoret edhe vlerësimi i shekullit 21.


Korniza e Kurrikulës së Kosovës paraqet dokumentin kryesor për ciklin e ri të reformave në sistemin e arsimit në Kosovë. Ajo promovon (a) të nxënësve që reflekton përvojat paraprake të fëmijëve, interesat dhe mundësitë e tyre, (b) të nxënësve që është kuptimplotë dhe (c) përfshirjen aktive të nxënësve në përzgjedhjen e përvojave të të nxënësve dhe vetëdijësimin e tyre për të vlerësuar dhe vetëvlerësuar.

KORNIZA E KURRIKULËS SË KOSOVËS




Korniza e Kurrikulës së Kosovës promovon një qasje që bazohet në kompetenca, të cilat zhvillohen përmes të nxënësve që bazohet në punën praktike. Kjo qasje ka ndikim të rëndësishëm për organizimin e përvojave mësimore në shkollë, integrimin e çështjeve ndërkurrikulare, aftësitë për jetë; mësimin e integruar; mësimdhënien dhe të nxënësve ndërvetësues; vlerësimin formativ dhe vlerësimin e progresit të nxënësve. Ajo promovon shfrytëzimin e Vlerësimit për nxënës në mënyrë të vazhdueshme që ta përmirësojë shkallën e arritshmërisë në nivel klase, komune dhe në nivel shtetëror. Shumëllojshmëria e praktikave të vlerësimit në klasë do të mundësojë vlerësim të arritshmërisë së nxënësve, që është në pajtim me stilet e ndryshme të të nxënësve¹.

Figura e mëposhtme tregon se sistemi i bazuar në kompetenca përfshin: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet, vlerat, emocionet, rutinat etj.



Për të ilustruar se si shkathtësitë relevante të nxënësve të identifikuar nga Programi për arsimin themelor (Basic Education Program) i mbulojnë dhe i kontribuojnë zhvillimit të kompetencave kyçe, është paraqitur tabela e mëposhtme. Programet për avancimin e mësimdhënësve në fushat e ndryshme mësimore kanë për objektiva zhvillimin e këtyre shkathtësive relevante tek nxënësit duke zbatuar metodologji të bazuara në të nxënësve përmes projekteve, zgjidhjes së problemeve, hulumtimit praktik etj, duke përdorur Vlerësimin e shekullit 21 apo Vlerësimin Formativ.

***Ndryshimet** në pritjet shoqërore, njohuritë për të nxënës dhe për motivimin ndikojnë në punën e mësimdhënësve, në atë se si japin mësim, çka u mësojnë nxënësve dhe në veçanti, si i zbatojnë praktikave të vlerësimit në klasë.*



¹ Korniza e Kurrikulës së Kosovës, fq. 62

Krahasim në mes të vlerësimit tradicional dhe vlerësimit të shekullit 21²

Shkollat në shekullin 21 e përfaqësojnë idenë për afrim të individualizuar i cili respekton aftësitë dhe përpjekjet e secilit fëmijë për të krijuar mënyrën e vet të të nxënës. Mësimdhënësit të cilët e përfaqësojnë këtë mendim janë të drejtuar kah fëmija. Fëmija ndodhet në qendrën e procesit të të nxënës, kurse mësimdhënësi vetëm krijon mjedisin i cili e reflekton këtë perspektivë. Vlerësimi si pjesë përbërëse e mësimdhënies dhe të nxënës duhet të shërbejë për t'i përgatitur nxënësit për t'i arritur shkathtësitë e nevojshme të shekullit 21.

Vlerësimi tradicional ndryshon nga ai i shekullit 21 si vijon:

Vlerësimi Tradicional	Vlerësimi i shekullit 21
Koha e caktuar për vlerësim.	Vlerësimi është i vazhdueshëm.
Shpeshherë ofrohet në formë të shkruar me përgjigje alternative.	Vlerësimi nënkupton formate të hapura.
Nota varet në bazë të vetëm një kontrollimi të diturisë.	Vlerësimi varet nga shumë gjëra.
Instrumentet për vlerësim u nënshtrohen normave të ndryshme.	Instrumentet për vlerësim u nënshtrohen kritereve të ndryshme.
Vlerësimi shënohet me nota.	Vlerësimi është i orientuar kah përparimi.
Suksesi varet nga memorizimi i informacioneve të prezantuara në çaste të caktuara.	Suksesi përcaktohet nëpërmjet bashkëpunimit dhe bisedimit gjatë një periudhe më të gjatë.
Zgjuarësia matet sipas aftësive linguistike (gjuhësore) dhe logjiko/matematikore.	Zgjuarësia matet gjatë zgjidhjes së problemeve nga jeta reale.
Përgjigja e saktë është vërtetim për përpjekjet dhe për të nxënës e nxënësit.	Pikëpamjet e nxënësve përdoren për t'u kuptuar perceptimi i tyre dhe me qëllim që ato pikëpamje të përfshihen në përmbajtjet e ardhshme mësimore
Vlerësimi është proces i ndarë nga procesi mësimor	Vlerësimi ndërlidhet me procesin mësimor

"Mendimet rreth vlerësimeve kanë pësuar ndryshime në vitet e fundit. Në këndvështrimin e ri, vlerësimi dhe të nxënës janë dy faqe të së njëjtës monedhë... Kur nxënës angazhohen në vlerësim, të nxënës e tyre rrjedh pikërisht nga ai vlerësim"

National Research Council, National Science Education Standards.
(Washington DC. National Academy Press, 1996)

2 Teksti është i adaptuar nga "Në kërkim për dituri: Klasa konstruktivistike" nga Martin dhe Jacqueline Brooks.

SHKATHËSITË

Basic Education Program

Përmes punës në grupe, nxënësit zhvillojnë shkathësitë e komunikimit, kreativitetin dhe e pranojnë mendimin e njëri tjetrit. Gjatë punës në grupe ata kuptojnë rolet e tyre në grup. Nxënësit do të zhvillojnë vetëdijen dhe vetëbesimin përmes aktiviteteve konkrete.



të menduarit kritik



vetëvlerësimi



puna grupore



udhëheqësia

KOMPETENCAT KRYESORE TË KURRIKULËS SË KOSOVËS

KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE TË SHPREHURIT
(Komunikues efektiv)

KOMPETENCA E TË MENDUARIT (Mendimtar kreativ)

KOMPETENCA E TË MËSUARIT (Nxënës i suksesshëm)

KOMPETENCA QË KA TË BËJË ME PUNËN, JETËN DHE MJEDISIN
(Kontribues Produktiv)

KOMPETENCA PERSONALE (Individ i shëndoshë)

KOMPETENCA QYTETARE (Qytetar i përgjegjshëm)




të lexuarit

E SHEKULLIT 21

Ata do të zhvillojnë ndërmarrësi, do të zhvillojnë dhe respektojnë oraret, dorëzimin e projekteve në kohë, do ta mësojnë procesin dhe rezultatet. Përdorimi i pajisjeve të shekullit 21 do t'u ndihmojë nxënësve të përgatiten për jetë dhe punë.

SHKATHTËSITË RELEVANTE TË BASIC EDUCATION PROGRAM



LEGJENDA

- te menduarit kritik
- vetëvlerësimi
- puna grupore
- të lexuarit
- TIK-u
- të zgjidhurit e problemit
- kreativiteti
- hulumtimi
- ndërmarrësia
- udhëheqësia
- gjuha e huaj



TIK-u



të zgjidhurit e problemit



kreativiteti



ndërmarrësia



gjuha e huaj




hulumtimi

Ngritja profesionale e mësimeve për Vlerësimin për Nxënie

Vlerësimi duhet të jetë pjesë përbërëse e planeve të punës së mësimeve, aktiveve (këshillave) profesionale dhe shërbimeve profesionale të shkollës.

Të nxënit e thellë dhe zbatimi i tij në praktikë kërkon më shumë se vetëm ndjekjen e punës apo trajnimeve të veçanta. Ngritja profesionale efektive nuk është thjeshtë shpërndarje e informatave tek mësimeve, por ai merr në konsiderim edhe punën e vazhdueshme të mësimeve në kontekste dhe mjedise të ndryshme me qëllim të përmirësimit të mësimeve të tyre dhe rezultateve të tyre.

Aktivitetet profesionale të mësimeve dhe udhëheqja e shkollës vazhdimisht kërkojnë forma të reja bashkëpunimi për ta rritur efektivitetin e tyre për të mirën e nxënësve. Ata veprojnë mbi bazën e atij bashkëpunimi dhe po ashtu bazohen në 'kërkime' në klasat dhe në shkollën e tyre. Rezultatet e këtij bashkëpunimi çojnë në gjetjen e rrugëve dhe mënyrave më të mira për vlerësimin e të arriturave në mësime dhe për vlerësimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe të arriturave të nxënësve në përgjithësi.



Të gjitha të dhënat dhe gjetjet duhet të jenë pjesë e planit zhvillimor dhe planit vjetor të shkollës. Trajnimet në nivel të shkollës, që përkrahen nga ky projekt marrin parasysh Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, Standardet e Vlerësimit, Kodin e Etikës për Vlerësim dhe bashkëpunimin ndërmjet vetë mësimeve dhe drejtorëve të shkollave ku ata punojnë.

2. Përkufizime për vlerësimin dhe llojet e vlerësimit

Ç'është vlerësimi?

"... proces i mbledhjes së të dhënave në mënyrë që të merren vendime për një individ apo një grup të caktuar." (Salvia and Ysslyde, 1998)

"... një varg metodash të përdorura për matjen e performancës dhe arritjes së nxënësve duke përfshirë, testimin, provimet, vlerësimet e punës praktike, vlerësimin me gojë, vlerësimet me bazë në klasë të udhëhequra nga mësimmshënësit." (Gipps, 1994)

"... është proces i kërkimit dhe interpretimit të provave nga nxënësit dhe mësimmshënësit e tyre për të vendosur se ku janë nxënësit, ku duhet të arrijnë ata dhe si të arrijnë atje më së miri." (Assessment reform group, 2002)

Kur dëgjojmë fjalën 'vlerësim', mendja na shkon tek provimet, testet, notat, stresi, sukcesi apo dështimi. Në këtë rast, mund të konstatojmë se fjala është për një produkt që ndahet nga procesi i mësimmshënies dhe i të nxënësit, për **Vlerësimin e të Nxënësit** (Vlerësimi Sumativ), që ndodh pas të nxënësit dhe na tregon se çfarë është arritur.

Nga ana tjetër, vlerësimi gjatë procesit të të nxënësit, (Vlerësimi Formativ) ka për qëllim që t'i informojë me kohë dhe me saktësi mësimmshënësit dhe vetë nxënësit për punën e bërë drejtë arritjes së Qëllimeve të të nxënësit. Në këtë rast mësimmshënësit e përshtatin mësimmshënien me nevojat e nxënësve, dhe nxënësit i përshtatin strategjitë e tyre të të nxënësit për qëllime të caktuara. Ky përdorim i vlerësimit, që njihet si **Vlerësimi për nxënies** (VpN) ndryshon nga Vlerësimi i të Nxënësit (ViN) sepse informacioni i mbledhur përdoret, për t'i ndihmuar nxënësve që ta përmirësojnë punën e tyre, derisa ata janë duke marrë njohuri të reja apo duke i zbatuar shkathtësitë e tyre. Mësimmshënësit të cilët e shohin vlerësimin si pjesë të pandashme të mësimit, i angazhojnë nxënësit e tyre si bashkëpunëtorë në procesin e të nxënësit.

Dy arsyt kryesore të vlerësimit janë:

- (1) **Ndihmon të nxënësit**
- (2) **Raporton nëse ka ndodhur të nxënësit, dhe me çfarë efekti është realizuar të nxënësit**

Të gjitha vlerësimet, qoftë ato përmbledhëse apo formative, i përmbajnë këta tre hapa:

- **Mbledhjen e të dhënave (informatave)**
- **Gjykimin në lidhje me të dhënat**
- **Shfrytëzimin e informatave për qëllime të caktuara**

Vlerësimi në klasë - llojet

Dy llojet më të përdorshme të vlerësimit në klasë janë:

- **Vlerësimi për nxënie - formativ** (mbikqyrë përparimin gjatë procesit të të nxënit, siguron informata kthyesë për ta lehtësuar të nxënit dhe për ta përmirësuar mësimdhënien);
- **Vlerësimi i të Nxënit - sumativ** (përcakton arritjet në përfundim të një detyre të caktuar, kapitullit, gjysmëvjetorit apo vitit shkollor për t'i vendosur notat dhe certifikimin e nxënësit për nxënie të mëtejshme. Ai përdoret edhe për ta gjykuar efektivitetin e mësimdhënies apo programit mësimor).



Vlerësimi për nxënie (VpN)/ Vlerësimi Formativ:

Mësimdhënësit bashkë me nxënësit vlerësojnë punën e bërë dhe i diskutojnë rezultatet me qëllim të përmirësimit të punës...
Vlerësimi mund të bëhet në çdo fazë të orës së mësimit – në fillim, gjatë dhe në fund të orës.



Vlerësimi i të Nxënit (ViN) apo Vlerësimi Sumativ:


Nxënësit i kryejnë detyrat e matematikës në testin e arritshmërisëdhe rezultati që ata tregojnë do të merret parasysh për regjistrimin e tyre në shkollë të mesme të lartë.

Kur zbatohen të dyja bashkë, edhe VpN edhe ViN, vlerësimi është më efektiv dhe rezultatet e mësimdhënies dhe të nxënies janë më të mira.

Në përgjithësi, Vlerësimi për nxënie (VpN) është proces i vëzhgimit sistematik që siguron një kuptim më të mirë të asaj se çfarë kanë mësuar nxënësit dhe si do të angazhohen ata thellësisht në procesin e të nxënies. Ai i drejton nxënësit në procesin e të nxënies dhe u mundëson atyre të fitojnë aftësi të nevojshme që do të jenë të dobishme për arritjen e rezultateve më të mira.

Vërejtje: Çdo vlerësim përfshin mbledhjen e të dhënave, **të gjykuarit** në lidhje me to, dhe shfrytëzimin e atyre informacioneve për ndonjë qëllim (si, përcaktimin e notës, informimin për mësimdhënien, ...). Në rastin e VpN-së, fjala **“gjykim”** i referohet thjeshtë asaj që mësimdhënësi mendon që nxënësit dinë në lidhje me qëllimet e të nxënies, e jo **‘sa mirë’** nxënësit mund ta kryejnë një detyrë të caktuar.


Vlerësimi për nxënie ndihmon nxënësit për të nxënë



*Ne nuk jemi duke argumentuar se një qasje e vlerësimit është e mirë dhe një tjetër e keqe: çështja kryesore është rreth **përshtatshmërisë për qëllimin e vlerësimit**.*

Shënime:

Qëllimet e VpN dhe ViN:

***Vlerësimi për nxënie ka për qëllim:***

- ***Të sigurojë një informatë kthyesë me qëllim të përmirësimit të të nxënësit;***
- ***T'i motivojë nxënësit për nxënie të mëtejshme;***
- ***T'i identifikojë anët e forta dhe ato të dobëta të nxënësve (shkaqet);***
- ***T'i orientojë nxënësit në profesionet e ardhshme;***
- ***T'i orientojë nxënësit për zhvillim individual;***
- ***Të klasifikojë, përzgjedhë dhe ndihmojë në proceset vendimarrëse;***
- ***Të sigurojë informacione të nevojshme për marrjen e vendimeve për zhvillimin dhe reformimin e sistemit arsimor;***
- ***Të sigurojë të dhëna për kërkime në shkencat e edukimit***

Shënime:

<p>Vlerësimi formativ apo Vlerësimi për nxënie (VpN)</p>	<p>Vlerësimi Sumativ (përmbledhës) apo Vlerësimi i të nxënësve (ViN)</p>
<p>Vlerësimi formativ shërben për të mbledhur informata kthyesë si dhe për të korigjuar më pas punën në secilën fazë të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Bloom (1969)</p> <p>Përdorim i të dhënave të ndryshme me qëllim të modifikimit dhe adaptimit të nevojave të cilat janë zbuluar nga faktet. Vlerësimi bëhet formativ vetëm atëherë kur vepohet mbi faktet.</p> <p>Black (1998)</p> <p>Çdo vlerësim i cili qëllim kryesor ka t'i shërbejë nxitjes së nxënësve për të nxënë...është zakonisht vlerësim joformal, i ngulitur në të gjitha aspektet e mësimnxënies dhe mësimdhënies, dhe i realizuar nga mësimdhënësi të ndryshëm si pjesë e stilit të mësimdhënies së tyre individuale.</p> <p>Black, Harrison, Lee, Marshall and Wiliam (2003).</p> <p>Çdo gjë që nxënësit bëjnë, si p.sh, biseda në grupe, përgjigje në pyetje, parashtrimi i pyetjeve, puna në grupe, dorëzimi i detyrave të shtëpisë – madje edhe mënyra se si është ulur i qetë apo konfuz – është burim potencial i informatës së çfarë ka kuptuar apo nuk ka kuptuar nxënësi.</p> <p>Mësimdhënësi i cili në mënyrë të vetëdijshme përdor vlerësimin për të përkrahur mësimnxënien, e pranon këtë informatë, e analizon dhe merr vendime të cilat i adresohen kuptimeve dhe keqkuptimeve që janë zbuluar.</p> <p>Thompson & Wiliam (2008)</p>	<p>Vlerësimi sumativ i referohet vlerësimeve të grumbulluara, që ndodhin zakonisht në fund të një njësie apo teme të caktuar, të cilat kanë për qëllim të masin se çfarë kanë mësuar nxënësit, apo deri në çfarë cilësie kanë mësuar, dhe për ta gjykuar performancën duke u bazuar në disa standarde.</p> <p>Megjithëse ne shpesh mendojmë se Vlerësimi sumativ është i njëjtë me testet tradicionale, kjo nuk është gjithmonë e saktë. Për shembull, Vlerësimi sumativ mund të vijë nga grumbullimi i fakteve për një kohë të caktuar, siç është grumbullimi i punës së nxënësit.</p> <p>National Research Council (2001)</p> <p>Mësimdhënësi në mënyrë periodike evidenton arritjen dhe progresin e nxënësit me qëllim të raportimit të prindërve, mësimdhënësve dhe personave tjerë relevantë... Vlerësimi i të nxënësve fokusohet më shumë në vlerësimin pas një periudhe të shkurtë apo më të gjatë. Në përgjithësi ai përfshin vlerësimin e të nxënësve në fund të një periode, si p.sh në fund të një njësie mësimore, një jave, një gjysmëvjetori apo në fund të vitit.</p> <p>National Council for Curriculum and Assessment (2007).</p>

- Vlerësimi është formativ kur mësimdhënësit mbledhin të dhëna dhe i interpretojnë provat e të menduarit të nxënësve apo kryerjes së detyrës, dhe pastaj t'i përdorin ato prova për të marrë vendime të mëtejme për mësimdhënien dhe të nxënësit.

Roli i mësimitdhënësve, nxënësve, drejtorëve dhe prindërve në Vlerësimin për Nxënie

Vlerësimi për nxënie (VpN) ndodhë në të gjithë procesin e të nxënit. Ai është ndërveprues, që bashkë me mësimitdhënësit mundëson:


- *përafrimin e mësimitdhënies me rezultatet e synuara-identifikimin e nevojave të veçanta të nxënësve apo të grupeve të caktuara për të nxënë*
- *zgjedhjen dhe përshtatjen e metodave, materialeve dhe burimeve krijimin e strategjive të ndryshme të mësimitdhënies dhe mundësive për t'i ndihmuar nxënësit të ecin përpara në të nxënit e tyre*
- *sigurimin e informatave kthyesë dhe orientimin e nxënësve*

Mësimitdhënësit e përdorin Vlerësimin për Nxënie për ta rritur motivimin e nxënësve dhe angazhimin e tyre për të nxënë.




*Vlerësimi për nxënie u mundëson mësimitdhënësve të marrin informacione të qarta se si ndodhë të nxënit tek secili nxënës në mënyrë **individuale***

*Mësimitdhënësit duhet ta planifikojnë Vlerësimin **për të** Nxënit (VpN) si pjesë përbërëse të **mësimitdhënies dhe të nxënit***



Kur mësimdhënësit angazhohen në të nxënit e fokusuar në vlerësim, ata ndryshojnë kulturën në klasë, përqëndrohen në suksesin e nxënësit. Ata e bëjnë të dukshëm atë që nxënësi beson se është e vërtetë, dhe i shfrytëzojnë të dhënat për t'i ndihmuar nxënësit që të ecin përpara në mënyrë efikase dhe të suksesshme.

Cikli i VpN-së – e sjellë nxënësin më afër qëllimeve të të nxënit ...



Nxënësit janë në qendër të Vlerësimit për nxënie, sepse ata e luajnë rolin kryesor në vlerësim. Çdo veprim që merr mësimdhënësi gjatë 'ciklit' të vlerësimit bëhet në ndërveprim me nxënësit. Mësimdhënësit vlerësojnë përparimin e nxënësve drejt përmbushjes së qëllimeve, kurse nxënësit duke i ditur ato qëllime, ofrojnë të dhëna në lidhje me të kuptuarit e tyre. Sa më shumë që nxënësit e vlerësojnë veten e tyre, aq më shumë do të jenë në gjendje të vendosin për hapat e tyre të ardhshëm për të nxënë.

Nga ana tjetër **drejtorët** luajnë rol vendimtar në kërkimin e mënyrave më të mira për strukturimin e mësimin, sigurimin dhe shpërndarjen e burimeve, motivimin e mësimdhënësve për ta ngritur cilësinë në punën e tyre të përditshme dhe bashkëpunimin me prindër dhe me palët tjera të interesit në të gjitha nivelet.

Drejtorët...

- **Përdorin masa të shumëllojshme për të krijuar një sistem vlerësimi që lidh në mënyrë të vazhdueshme mësimdhënien dhe të nxënësit;**
- **Mbështesin mësimdhënësit për ngritje profesionale dhe për freskim të njohurive në mënyrë sistematike;**
- **Sigurojnë një proces monitorimi të vazhdueshëm për të siguruar përmbushjen e objektivave që dalin nga plani zhvillimor i shkollës;**
- **Inkurajojnë përfshirjen e prindërve në proceset e Vlerësimit për të nxënësit për t'iu ndihmuar fëmijëve të tyre për arritje më të larta;**
- **Bashkëpunojnë me të gjitha palët e interesit për ta ngritur cilësinë e të nxënësit të nxënësve në shkollën e tyre.**

VpN u mundëson ...


- **Nxënësve**, të marrin pjesë në mënyrë aktive për të kuptuar se si dhe çfarë duhet bërëpër të ecur përpara;
- **Mësimdhënësve**, të gjykojnë mirë për arritjet e nxënësve dhe t'i shfrytëzojnë ato gjykime për të bërë plane shtesë...
- **Shkollave/Drejtorëve**, të vendosin një sistem të vlerësimit të strukturuar dhe sistematik që është i menaxhueshëm dhe i dobishëm ...
- **Prindërve** dhe kujdestarëve, të informohen se si po përparojnë fëmijët e tyre, çfarë duhet të bëjnësi mund t'i mbështesin ata dhe mësimdhënësit e tyre.

Përmbledhje për qëllimet e VpN-së dhe ViN-së

	VpN	ViN
Pse vlerësojmë?	<i>u mundëson mësuesve të përcaktojnë hapat e ardhshëm për përparim të nxënësve</i>	<i>të vërtetojë ose t'i informojë prindërit ose palët tjera të interesit për rezultatet e nxënësve</i>
Çfarë vlerësohet?	<i>Përparimi i secilit nxënës dhe kërkesat e nxënësve në raport me rezultatet e nxënësve sipas kurrikulës</i>	<i>Niveli që mund të arrijë secili nxënës për t'i zbatuar konceptet bazë, njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e lidhura me rezultatet e nxënësve sipas kurrikulës</i>
Me cilat metoda?	<i>Një varg metodash në forma të ndryshme që bëjnë të dukshëm të kuptuarit dhe shkathtësinë e nxënësve</i>	<i>Një varg metodash në forma të ndryshme që vlerësojnë të dyja, produktin dhe procesin</i>
Sigurimi i cilësisë	<i>Saktësia dhe qëndrueshmëria e vëzhgimeve, dhe interpretimi i të nxënësve:</i> <ul style="list-style-type: none"> • i qartë, pritje të detajuara të të nxënësve; • i saktë, shënime të hollësishme për informatat kthyesë për secilin nxënës 	<i>Saktësia dhe qëndrueshmëria, dhe gjykime të drejta të bazuara në të dhëna të cilësisë së lartë</i> <ul style="list-style-type: none"> • i qartë, pritje të detajuara të të nxënësve; • i drejtë dhe raportim i saktë përmbledhës
Shfrytëzimi i informatave	<i>Sigurojnë për çdo nxënës informata përshkruese për të nxënësve e tij/saj të mëtejme</i> <ul style="list-style-type: none"> • ndryshojnë mësuesin vazhdimisht duke kontrolluar ku janë nxënësve në raport me rezultatet kurrikulare • sigurojnë për prindërit apo kujdestarët informata kthyesë përshkruese për të nxënësve e fëmijëve të tyre dhe u japin atyre ide për mbështetje 	<ul style="list-style-type: none"> • tregojnë nivelin e të nxënësve të secilit nxënës • sigurojnë bazën për diskutime ose për përkrahje • raportim të drejtë, të saktë dhe informim të detajuar i cili mund të shfrytëzohet për të vendosur për qëllime të ardhshme.

Parimet e Vlerësimit për Nxënie –VpN

Në vitin 2002, grupi për reformimin e vlerësimit³ i ka publikuar **dhjetë parimet** e mëposhtme, të cilat janë bazë për suksesin e përgjithshëm:



Shënime:

³ www.assessment-reform-group.org.uk.

3. Zbatimi i strategjive për Vlerësimin për Nxënie

Metodat e vlerësimit duhet të jenë të përshtatshme për qëllimet dhe kontekstin e vlerësimit

Vlerësimi si pjesë e mësimdhënies dhe e të nxëniet

Vlerësimi për nxënie përfshin përdorimin e strategjive dhe metodave të ndryshme me qëllim të ngritjes së rezultateve të nxënësve në mësim. Kjo arrihet më së miri nëse nxënësit e kuptojnë qëllimin e të nxëniet, ku gjenden ata në raport me ato qëllime dhe në çfarë mënyre mund të arrijnë t'i përmbushin ato. Duke u bazuar në *Parimet e Vlerësimit për nxënie* dhe *Standardet e Vlerësimit*, vlerësimi si komponente e mësimdhënies dhe mësimnxënies përfshin:

- **Shkëmbimin e qëllimeve të të nxëniet me nxënësit;**
- **Orientimin dhe ndihmën e nxënësve drejt përmbushjes së standardeve të caktuara;**
- **Besimin që secili nxënës mund të përmirësohet në raport me të arriturat paraprake;**
- **Përdorimin e vlerësimit të ndërsjellë dhe vetëvlerësimit për të zbuluar aspektet në të cilat nxënësi duhet të përmirësohet;**
- **Përfshirja e mësimdhënësve dhe nxënësve në rishikimin dhe reflektimin e informatave për vlerësim.**

Nxënësit duhet të informohen në lidhje me vlerësimin, arsyen pse ata do të vlerësohen dhe se si do të përdoren rezultatet

Shkollat dhe mësimdhënësit duhet të praktikojnë një sistem të drejtë, të besueshëm dhe transparent të vlerësimit. Nxënësit dhe prindërit duhet të njoftohen me kohë dhe në mënyrë adekuate me rezultatet e pritura, mjetet, procedurat dhe kriteret e vlerësimit⁴.

Dy dokumente të rëndësishme që i ndihmojnë shkollat në përmbushjen e detyrave të tyre me përgjegjësi, në lidhje me vlerësimin, janë Kodi i Etikës për Vlerësim si dhe Standardet e Vlerësimit⁵.

4 Korniza e Kurrikulës së Kosovës, fq. 63

5 http://www.masht-gov.net/advCms/documents/UA_standardet.pdf
http://www.masht-gov.net/advCms/documents/UA_Kodi_i_etik.pdf

Karakteristikat e Vlerësimit për nxënie

Vlerësimi për nxënie (VpN) mundëson:

- ✓ **Vlerësim të saktë** – duke i njohur standardet, duke e gjykuar drejtë punën e nxënësve dhe duke vlerësuar saktë në bazë të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës;
- ✓ **Vlerësim të drejtë** - duke e ditur se metodat e shfrytëzuara janë të vlefshme;
- ✓ **Vlerësim të besueshëm** – duke u siguruar se gjykimet janë të qëndrueshme dhe të bazuara në një gamë të dhënash;
- ✓ **Vlerësim të dobishëm** – duke i identifikuar pengesat e përparimit të nxënësve dhe duke i shfrytëzuar ato të dhëna për të planifikuar dhe për t'i shqyrtuar hapat tjerë të të nxënësve;
- ✓ **Vlerësim të fokusuar** – duke i identifikuar fushat ku nxënësit kanë pengesa për të përparuar, përqëndrim në fusha të caktuara dhe punë hap pas hapi;

Karakteristikat e VpN dhe përshtatja me strategjitë e mësimdhënies⁶

Karakteristikat themelore të VpN	Strategjitë e mësimdhënies
Ndarja e Qëllimeve të të nxënësve bashkë me nxënësit	<ul style="list-style-type: none"> • ndani qëllimet e mësimin në fillim të orës mësimore dhe kur është e përshtatshme, në gjuhën që është e kuptueshme për nxënësit; • përdorni këto qëllime si bazë për të bërë pyetje dhe për të shkëmbyer informacione; • vlerësoni këto informacione në raport me arritshmërinë e qëllimeve mësimore për njoftimin me hapat e ardhshëm të planifikimit.
Ndihma e nxënësve për të njohur standardet që ata synojnë	<ul style="list-style-type: none"> • jepni kritere të qarta të suksesit dhe lidhni ato me objektivat e të nxënësve, • shkruani shembuj të mirë në tabelë; • tregoni nxënësve punët që i kanë plotësuar kriteret me shpjegime, • siguroni se janë paraqitur qartë pritshmëritë e lidhura me prezantimin e punës, • paraqitni punën e nxënësve që tregon një përparim
Përfshirja e nxënësve në vlerësimin e bashkëmoshatarëve dhe vetëvlerësim	<ul style="list-style-type: none"> • mundësoni që nxënësit të marrin përgjegjësinë për të biseduar për ato që kanë mësuar dhe se çfarë ishte e vështirë për ata për t'i përmbushur qëllimet e të nxënësve • inkurajoni nxënësit për të punuar/diskutuar bashkë, duke u përqëndruar në atë se si t'i përmirësojnë të arriturat e tyre, • kërkoni nga nxënësit t'i shprehin mendimet e tyre "Si e gjetët përgjigjen?" • jepni kohë nxënësve të reflektojnë për të nxënësve të tyre • identifikoni bashkë me nxënësit hapat e ardhshëm të të nxënësve

⁶ Pedagogy and Practice: Teaching and Learning in Secondary Schools - Unit 12: Assessment for learning. DFES 2004. Ref: DFES 0435-2004 G

Karakteristikat themelore të VpN	Strategjitë e mësimdhënies
<i>Sigurimi me informata kthyesë të cilat u mundësojnë nxënësve të njihen me hapat e ardhshëm, dhe mënyrën e realizimit të tyre</i>	<ul style="list-style-type: none"> • jepni informata kthyesë me gojë dhe me shkrim • sigurohuni se informatat janë dobiprurëse dhe pozitive, të cilat identifikojnë se nxënësi e ka bërë mirë detyrën, çfarë duhet të bëjë ai/ajo për të përmirësuar atë punë dhe si duhet ta bëjë • identifikoni që hapat e ardhshëm të jenë të përshtatshëm për grupet e nxënësve apo për nxënësin në veçanti
<i>Garantimi i besueshmërisë që çdo nxënësi ka mundësi ta përmirësojë punën e tij/saj</i>	<ul style="list-style-type: none"> • identifikoni hapa të vegjël që u mundësojnë nxënësve të shohin përparimin e tyre me besueshmëri dhe vetë-besim • inkurajoni nxënësin ta shpjegojë të menduarit dhe të arsyetojë në klasë, të sigurtë, ku mbizotëron një etikë e lartë.
<i>Përfshirja e mësimdhënësve dhe nxënësve në rishikimin dhe reflektimin e informatave për vlerësim</i>	<ul style="list-style-type: none"> • reflektoni bashkë me nxënësin për punën e tyre, p.sh. nëpërmjet hapave që janë zhvilluar gjatë hetimit të një 'ngjarjeje' • zgjedhni detyra të përshtatshme për të dhënë informata cilësore, (me theks të veçantë në proces e jo sa për t'i korigjuar përgjigjet) • siguroni kohë të mjaftueshme që nxënësin të mund të reflektojnë për ato që i kanë mësuar dhe kuptuar në mënyrë që të identifikohen çështjet për të cilat ata ende kanë vështirësi • rishikoni planifikimin, vlerësoni efikasitetin e detyrave, burimeve, etj, si rezultat i vlerësimit tuaj dhe të nxënësve.

Mbani mend...

Karakteristikat e Vlerësimit për nxënie

- Shkëmbimi i qëllimeve të nxënies me nxënësin;
- Ndhmë nxënësve për njohje me standardet drejt të cilave synohet;
- Sigurimi i informatës kthyesë që u ndihmon nxënësve se si duhet të përmirësohen;
- Besimi që secili nxënësi mund të përmirësohet në raport me të arriturat paraprake;
- Shqyrtim dhe reflektim i ndërsjellë i të arriturave dhe i përparimit të nxënësve nga mësimdhënësit dhe nxënësin;
- Aftësimi i nxënësve për përvetësim të teknikave të vetëvlerësimit për t'i zbuluar aspektet në të cilat duhet të përmirësohen;
- Besimi se motivimi dhe vetëbesimi janë faktorët kryesorë që të nxënësit dhe përparimi të jenë efektive, dhe se ato mund të përmirësohen duke shfrytëzuar teknika efektive të vlerësimit.

Hulumtimet kanë dëshmuar se kur nxënësit marrin pjesë në procesin e të nxënësit dhe vlerësimit të tij, rriten standardet e arritshmërisë dhe nxënësit inkurajohen të ndër marrin veprime për përmirësimin e të nxënësit të tyre. Për këtë arsye është e nevojshme që mësimdhënësit të përdorin strategji efektive që mundësojnë përmbushjen e karakteristikave të vlerësimit për të nxënësit.

Gjashtë strategjitë kryesore të Vlerësimit për nxënie janë:

- **Shkëmbimi (ndarja) e qëllimeve të të nxëniet**
- **Ndarja e kritereve të suksesit**
- **Dhënia e informatave kthyesë**
- **Vlerësimi i ndërsjellë (i bashkëmoshatarëve)**
- **Vetëvlerësimi**
- **Përdorimi i teknikave efektive të parashtrimit të pyetjeve**

3.1. Qëllimet e të nxëniet

Mësimdhënësi gjatë planifikimit për *Vlerësimin për Nxënie (Vlerësimin Formativ)* duhet t'i kushtojë vëmendje: vlerësimit që kërkohet para të nxëniet; ndarjes së qëllimeve dhe kritereve së bashku me nxënësit, procesit të të pyeturit, vëzhgimit, vetëvlerësimit dhe vlerësimit të ndërsjellë (nga njëri-tjetri).

Qëllimet e të nxëniet

Qëllimet e të nxëniet janë deklarata të shkurtëra që përshkruajnë se çfarë duhet nxënësit të dinë, të kuptojnë apo çfarë janë në gjendje të bëjnë deri në fund të orës mësimore (mësimit, një serie të mësimëve ose të një detyre)..

Qëllimet e të nxëniet paraqesin ato çfarë nxënësit duhet të mësojnë. Qëllimet e të nxëniet përcaktohen nga rezultatet e të nxëniet të Kurrikulës bërthamë. Zakonisht shkruhen në tabelë, në veten e parë njëjës/shumës dhe mund të fillojnë me shprehjen:

Ne do të mësojmë:

- **të shumëzohjmë duke shfrytëzuar mbledhjen e përsëritur**
- **ta shkruajmë një 'kërkesë'**
- **të punojmë në grupe në mënyrë efektive**

Është shumë e rëndësishme që qëllimet e të nxëniet të shkruhen qartë në një gjuhë të kuptueshme për nxënësit dhe të vendosën në tabelë, sepse ka raste kur nxënësit në vend se të fokusohen në atë se çfarë po mësojnë (qëllimin), ata mendojnë dhe bisedojnë për atë se çfarë po bëjnë (kontekstin).

Qëllimet e të nxëniet në të shumtën e rasteve lidhen me kontekstin/detyrën.

Shpesh, të dyja, edhe qëllimi edhe konteksti mund të kombinohen së bashku si qëllim i vetëm.

Shembull: - të shumëzojnë duke shfrytëzuar mbledhjen e përsëritur, me kalkulatorë.

Nëse bëhet e qartë se cili është qëllimi i të nxënësve dhe cili është konteksti, nxënësit janë në gjendje t'i transformojnë aftësitë e tyre (për të shumëzuar) edhe nëse ndryshohet konteksti (pra, nëse në vend të kalkulatorit përdoren petëzat, ose 'memorizimi').

'Qëllimi i të nxënësve është elementi i parë aktiv i vlerësimit formativ në klasë...Pa qëllimet e të nxënësve, fëmijët janë viktimë e tekeve të mësimdhënësve.'

Shirely Clarke, 2002

Mbani mend!

- Qëllimet e të nxënësve duhet të shënohen në tabelë, në fillim të orës mësimore
- Qëllimet e të nxënësve duhet të ndahen nga konteksti apo aktiviteti;
- Nxënësit duhet të informohen se çfarë dhe pse do të mësojnë një mësim të caktuar si dhe të ndërlihet qëllimi me kurrikulën dhe jetën e përditshme;
- Qëllimet e të nxënësve duhet të shkruhen në një gjuhë të përshtatshme për moshën e fëmijëve;
- Qëllimet e të nxënësve duhet të jenë të njëjta për të gjithë nxënësit.

Qëllimi i të nxënësve	Konteksti
- të shumëzojnë duke shfrytëzuar mbledhjen e përsëritur	Duke përdorur kalkulatorin, numratorin apo burime tjera
- ta shkruajnë një 'kërkesë'	Duke shkruar një kërkesë kryetarit të komunës për ndërtimin e një qendre rinore.
- të mësojnë të punojnë në grupe në mënyrë efektive	Duke shkruar dhe punuar në grupe një fletëpalosje për të ushqyerit e shëndetshëm


3.2. Kriteret e Suksesit

Termi 'kriteret e suksesit' është përdorë për herë të parë në Britani të Madhe si sinonim për 'kriteret e vlerësimit'. Kështu, në vend që nxënësve t'ua rikujtojmë se duhet vlerësuar puna e tyre (me notë), kriteret në fjalë i përqëndrojnë ata në përvoja pozitive, në aftësitë e nxënësve për të qenë të suksesshëm.

Derisa, qëllimet e të nxënësve shërbejnë për të kuptuar se 'çfarë' dhe 'pse' po mësojnë kriteret e suksesit shërbejnë për të kuptuar se 'si do ta dimë nëse e kemi mësuar mësimin apo kemi qenë të suksesshëm?'. E rëndësishme është se, kriteret e suksesit i japin përgjigje të njëjtës pyetje edhe nga këndvështrimi i nxënësve: **Si do ta di nëse i kam realizuar qëllimet e të nxënësve?**

Me nxënësit duhet të diskutohet jo vetëm se *çfarë dhe pse do të mësojmë*, por edhe *si do të dimë nëse e kemi mësuar*.

- **Qëllimi i të nxënit (Çfarë dhe pse do të mësojmë?)**
- **Kriteret e suksesit (Si do ta dimë nëse e kemi mësuar?)**



Pra, përdorimi i kriterëve të suksesit ka ndikim të dukshëm si në mësimdhënie ashtu edhe në nxënie, e kryesisht tek nxënësit të cilëve u mundësohet ta vlerësojnë veten dhe shokët/shoqet e tyre.




Fig.1. Nxënësit vlerësojnë njëri tjetrin duke krahasuar punën e tyre me kriteret e suksesit

'Tani është shumë më lehtë për të mësuar sepse ne e dimë se çfarë të bëjmë dhe si t'i kryejmë detyrat'

Nxënëse e klasës V-të

Kriteret e suksesit janë ngushtë të ndërlidhura me qëllimet e të nxënit, ato janë 'hapat' për të arritur deri tek qëllimi. Kriteret e suksesit zakonisht formohen së bashku me nxënësit. E rëndësishme është që edhe qëllimet e të nxënit edhe kriteret e suksesit të diskutohen së bashku me nxënësit dhe të vendosen në tabelë në mënyrë që ata të përqëndrohen në ato gjatë gjithë punës së tyre. Kriteret e suksesit shërbejnë si bazë e vlerësimit të punës së nxënësve, qoftë nga mësimdhënësit apo vetë nxënësit. Me paraqitjen e kriterëve të suksesit nxënësit

do ta vlerësojnë punën e tyre apo të njëri-tjetrit në mënyrë korrekte dhe të drejtë duke mos vlerësuar elementet të cilat nuk kanë qenë kritere të suksesit. Po ashtu kriteret shërbejnë për një punë të pavarur të nxënësve për tu mbështetur në to dhe jo tek shoku/shoqja apo mësimdhënësi. Kjo është një vlerë e cila do t'u shërbejë atyre edhe në jetën e përditshme.

Gjatë formimit të kriterëve të suksesit duhet pasur kujdes të theksohet 'procesi dhe karakteristikat' dhe jo 'produkti final'.

Në tabelën e mëposhtme, në anën e majtë janë paraqitur rezultatet e punës së nxënësve kurse në anën e djathtë janë kriteret e suksesit të cilat i tregojnë hapat që duhet përcjellur për të arritur qëllimin e të nxënësve. Nëse nxënësit i kanë përcjellur ata hapa, ata kanë mësuar se si të punojnë në grupe në mënyrë efektive..


<ul style="list-style-type: none"> • Qëllimi i të nxënësve: • Ne do të mësojmë se si të punojmë në grupe në mënyrë efektive • Konteksti: Duke punuar një fletëpalosje për të ushqyerit e shëndetshëm 	
<p>Kriteret e suksesit/ Si do ta dimë nëse kemi qenë të suksesshëm?/Kërkesat e mësimdhënësit</p>	
<p>Nuk janë kritere të suksesit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • grupi ynë punoi bashkë • grupi ynë i respektoi të gjitha rregullat 	<p>Kritere të suksesit</p> <ul style="list-style-type: none"> -ndani rolet e secilit për punën që duhet bërë -nëse nuk pajtoheni me shokun/shoqen, argumentoni arsyen -gjysma e nxënësve të shkruaj për ushqimin e shëndetshëm; ndërsa gjysma tjetër për ushqimin jo të shëndetshëm -secili nxënës i grupit të shkruaj nga një artikull për të ushqyerit

Për të rritur ndikimin në të nxënësve, kriteret e suksesit....


- **Duhet të jenë të qarta dhe të shkruara në gjuhë të kuptueshme për të gjithë nxënësit;**
- **Duhet të jenë të njëjta për të gjithë nxënësit – diferencimi dhe mbështetja për nxënës me nevoja të ndryshme bëhet nëpërmjet aktiviteteve;**
- **Mund të shfrytëzohen për realizimin e rezultateve të kurrikulës, duke përfshirë edhe shkathtësitë për përdorimin e teknologjisë, shoqërizimin, për të menduarit në mënyrë kritike dhe kreative, etj;**

1. Biologji (Shkenca)

Shembull: Në orën e biologjisë, mësimitdhënësi bashkë me nxënësit shikojnë një videofilm. Mësimitdhënësi u kërkon nxënësve të mendojnë se çfarë do të shkruanin për filmin e shikuar. Ata vendosën të shkruajnë një ese në lidhje me ndotjen e lumit 'Drini i Bardhë'. Paraprakisht, bashkë me nxënësit, mësimitdhënësi përcakton 'kriteret e suksesit' si më poshtë:



Duke u mbështetur në këto kritere, nxënësit e kanë më të lehtë të shkruajnë për temën.



← Përshkruajmë...

← Identifikojmë...

← Vlerësojmë...

2. Matematikë

Kriteret e suksesit në lëndën e matematikës:

Arsyetimi dhe marrja e vendimeve janë thelbësore në të menduarit matematikor, prandaj ato duhet të jenë të integruara në kriteret e suksesit. Kështu, kriteret e suksesit bëhen thjeshtë pjesë e algoritmeve, procedurave dhe e udhëzimeve për të nxënit. Për shembull, kur mësohet 'zbritja' duke shfrytëzuar drejtëzën numerike për ta gjetur diferencën (ndryshimin) ndërmjet dy numrave, kriteri i suksesit duket ndryshe me/pa vendim-marrje:

Algoritmi	Përfshirja në 'vendimin për punën'
<ul style="list-style-type: none"> • Shkruaj numrin më të vogël në anën e majtë të drejtëzës numerike. • Shkruani numrin më të madh në anën tjetër. • Kalo në dhjetëshen më të afërt, etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Vendosni se cilët janë numrat dhe i vëni ato në drejtëzën numerike. • Llogaritni ndryshimet ndërmjet numrave me saktësi. • Kontrolloni përgjigjet me shokun dhe binduni nëse pajtoheni me përgjigjet

Kështu, nëse mësimi fokusohet në të kuptuarit e zbritjes dhe shfrytëzimin e drejtëzës numerike për t'i ndihmuar llogaritjet, nxënësit që e kanë të qartë 'zbritjen' nuk është e nevojshme t'i ndjekin hap pas hapi udhëzimet e paraqitura, por për të tjerët që kanë vështirësi në të kuptuarit e koncepteve të reja, udhëzimet hap pas hapi u ndihmojnë në përmirësimin e të kuptuarit. Pra, kriteret e suksesit mund të kenë një element të marrjes së vendimit, kontrollit apo arsyesimit dhe si të tilla ndihmojnë në përmbushjen e *qëllimit të nxënit*.

Nëse nxënësit kanë vështirësi për t'i përmbushur qëllimet e të nxënit, lista e kriterëve plotësohet me kërkesa shtesë:

- *Përshkruani problemin me fjalët tuaja dhe ia tregoni shokut/shoqes.*
- *Flisni për ato që keni bërë deri tani.*
- *E ndani problemin në hapa të vegjël.*
- *Vizatoni (modeloni) diçka që ju ndihmon (p.sh. drejtëzën numerike).*
- *Provoni nëse kjo ju çon në zgjidhje! Nëse jo provoni ta përmirësoni atë.*

Kriteret e suksesit dhe qëllimi i të nxënit mund të shkruhen edhe në veten e parë, në një gjuhë të përshtatshme për nxënësit.

Për shembull:

Unë di si rumbullakësohet një numër deri tek dhjetëshja më e afërt sepse:

- Kam përdorur vijën numerike për të rumbullakësuar pesë numra drejt dhjetëshes më të afërt;
- Ia kam shpjeguar dikujt rumbullakësimin e numrave;
- Kam kontrolluar rumbullakësimin e bërë nga dikush tjetër dhe e kam diskutuar me të.

3. Gjuhë shqipe

a) Nxënësve të klasës së tretë u kërkohet të shkruajnë një ese për vjeshtën.

Rezultatet e të nxënit nga Kurrikula: Shkruan drejtë dhe pa gabime drejtëshkrimore ese për tema të caktuara.

Rezultati i të nxënit nga kurrikula thjeshtohet dhe shkruhet në një gjuhë të përshtatshme për nxënës si p.sh:

*Qëllimi i të nxënit: **Sot do të mësojmë si të shkruajmë një ese.** (shënohet në tabelë)*

Konteksti: Duke shkruar një ese për vjeshtën (nuk shënohet në tabelë)

Tema: Vjeshta

Kriteret e suksesit:

- Vendos titullin sipas dëshirës
- Shkruaj së paku dy paragrafe
- Përdor fjalët: gjelbërim, natyrë, shëndeti, moti, zogjtë...
- Kujdes në drejtëshkrim dhe shenjat e pikësimit
- Paraqit peisazhin me vizatim

b) Shembull i kriterëve të suksesit të shënuara në veten e parë. Ora e gramatikës (përdorimi i ndajfoljeve)

Kriteret e suksesit:

- kam nënvizuar ndajfoljet në tekstin e dhënë
- kam klasifikuar ndajfoljet sipas asaj që tregojnë: kohën, mënyrën, sasinë, vendin
- kam paraqitur në tabelë ndajfoljet sipas llojeve të tyre


c) Kriteret e suksesit për shkrimin e autobiografisë:

Kriteret e suksesit:

- Shkruaj në veten e parë.
- Përfshij ndjenjat e tua.
- Shtoj fjali të përbëra.
- Përfshij një hyrje që e tërheqë lexuesin.
- Përfshij së paku një 'krahasim'.
- Mbaj lexuesin të interesuar duke shtuar sa më shumë detaje që mundesh.

- **Mbani mend:** Kriteri i suksesit nuk formulohet si pyetje!
- Si kryhet procesi i fotosintezës? Kjo pyetje nuk paraqet kriter të suksesit.
- Një kriter sukse si mund të formulohet në këtë mënyrë:
- Shpjego rëndësinë e procesit të fotosintezës

d) Shembull i paraqitjes së kriterëve në mënyrë të gabuar!



e) Shembull i paraqitjes së kriterëve në mënyrë të drejtë:

Qëllimi i të nxënës:	Të mësojnë të bëjnë dallimin në mes organizmave njëqelizore dhe atyre shumëqelizore
Kriteret e suksesit: - Ndaj organizmat sipas qelizave; - Klasifiko dhe emëro organizmat njëqelizore dhe shumëqelizore; - Përmendi dallimet ndërmjet organizmave njëqelizore dhe shumëqelizore në të ushqyer dhe shumim; - Përmendi ngjashmëritë e organizmave njëqelizore dhe shumëqelizore;	

Kriteret e suksesit shpesh paraqiten edhe me shembuj apo modele e jo vetëm me shkrim. Tek nxënësit që ende nuk dinë të lexojnë apo edhe tek nxënësit më të rritur kur kanë për detyrë të konstruktajnë diçka, shumë më lehtë është të shohin p.sh një projekt apo detyrë e cila i ka përmbushur të gjitha kriteret si dhe një projekt apo detyrë e cila nuk i ka përmbushur kriteret. Gjithmonë duke respektuar anonimitetin e nxënësve që i kanë punuar, preferohet që të jenë shembuj të nxënësve të gjeneratave të mëparshme.

Shënime:




Shembulli për klasën e parë i cili shërben si kriter i suksesit

Kriteret e suksesit shpesh kërkohen të shkruhen nga vetë nxënësit. Kështu, për shembull, në klasën e katërt, mësuesi u kërkoi nxënësve të punojnë në grupe për të vendosur se cila rrethojë e fushave të dhëna kushton më lirë dhe më pas t'i shkruajnë edhe 'kriteret e suksesit'.

Cila nga dy planimet e fushave të lojës, do të kushton më lirë nëse ato duhet të rrethohen me rrethojë të njëjtë?




Vërejtje: 1 cm në fletore tuaj - në realitet është 1 m.

Njëri grup i formulon kështu kriteret e suksesit:



Për detyrat që kërkojnë më shumë kohë, shpesh mësimdhënësit i përdorin rubrikat të cilat përmbajnë një apo më shumë **kritere të suksesit** dhe përshkrimet e një numri të niveleve të ndryshme të performancës në lidhje me këto kritere.

Më poshtë është paraqitur një rubrikë në të cilën është dhënë një kriter i suksesit dhe janë përshkruar tri nivele të performancës që lidhen me atë kriter.

Qëllimi i të nxënit			
Vetëdijësimi për ndikimin e peshkimit komercial në mjedisin detar	Jepni një shembull të përshtatshëm për ndikimin e peshkimit komercial në mjedisin detar. Jepni disa detaje në lidhje me shembullin.	Jepni dy ose më shumë shembuj për ndikimin e peshkimit komercial në mjedisin detar. Diskutoni disa detaje për të dy shembujt.	Jepni tre ose më shumë shembuj për ndikimin e peshkimit komercial në mjedisin detar. Diskutoni detajet e rëndësishme të secilit shembull.

Duke iu referuar kritereve të suksesit dhe rubrikës përshkruese të performancës,

- **Nxënësit** janë në gjendje ta vlerësojnë progresin e tyre, ndërsa në procesin e përfundimit të një detyre apo aktiviteti, ata i vlerësojnë arritjet e tyre përfundimtare;
- **Bashkëmoshatarët** janë në gjendje të sigurojnë informata kthyesë për shokët/shoqet e tyre në pikat më të rëndësishme, derisa ata janë në procesin e plotësimit të detyrës ose aktivitetit;
- **Mësimdhënësi/ja** është në gjendje të japë informata kthyesë, të cilat nxënësit i shfrytëzojnë për ta përmirësuar punën e tyre.

Rubrika e paraqitur përdoret gjatë ndonjë prezantimi dhe ka gjashtë kritere, po ashtu janë të renditura edhe nivelet varësisht nga shkalla e performancës. Rubrikat e ngjashme mund të përdoren për vlerësim nga mësimmshënësi, mund të shërbejnë për vetëvlerësim apo për vlerësim të ndërsjellë.

Emri i nxënësit/es _____

Është i përgatitur	Nxënësi është krejtësisht i përgatitur dhe shihet se ka bërë prova paraprake.	Nxënësi duket goxha i përgatitur, por mbase ka pasur nevojë të bëjë prova (praktikojë) pak më shumë.	Nxënësi është disi i përgatitur, por është e qartë se mungojnë provat paraprake.	Nxënësi nuk duket fare i përgatitur për të prezantuar.
Flet qartë	Flet qartë dhe dallueshëm gjithë kohën, dhe shqipton mirë çdo fjalë.	Flet qartë dhe dallueshëm gjithë (100-95%) kohën, por shqipton gabim një fjalë.	Flet qartë dhe dallueshëm, por shqipton disa fjalë gabim.	Shpesh belbëzon apo nuk kuptohet, OSE shqipton gabim shumë fjalë.
Nuk del nga tema	Qëndron në temë gjatë gjithë (100%) kohës.	Qëndron në temë shumicën (99%-90%) e kohës.	Qëndron në temë një pjesë (89%-75%) të kohës.	Ishte e vështirë të kuptohej se cila ishte tema.
Përmbajtja	Tregon se e ka kuptuar plotësisht temën dhe e shpjegon pikë për pikë duke e shoqëruar me shembuj.	Tregon se e ka kuptuar mirë temën dhe e prezanton pikë për pikë me disa shembuj.	Tregon se ka kuptuar disa pjesë të temës. Duket sikur thjesht po u flet njerëzve dhe jo sikur po e shtjellon temën pikë për pikë.	Nuk duket se e ka kuptuar shumë mirë temën. Është e vështirë të kuptohet se cilat janë pikat kryesore.
Qëndrimi dhe kontakti me sy	Qëndron në këmbë me trupin drejt, duket i relaksuar dhe plot vetëbesim. E shikon secilin pjesëmarrës në sy gjatë gjithë prezantimit.	Qëndron në këmbë me trupin drejt dhe i sheh të gjithë në sy gjatë prezantimit.	Nganjëherë ngrihet në këmbë, qëndron drejt dhe i sheh pjesëmarrësit në sy.	Rri i kërrusur dhe/ose nuk shikon në drejtim të pjesëmarrësve gjatë prezantimit.
Entuziazmi	Shprehjet e fytyrës dhe gjestet zgjojnë interesim dhe entuziazëm të madh nga të tjerët në lidhje me temën.	Shprehjet e fytyrës dhe gjestet herë pas here zgjojnë interesim dhe entuziazëm të madh nga të tjerët në lidhje me temën.	Përdor shprehjet e fytyrës dhe gjestet për të zgjuar interesimin dhe entuziazmin, por duken paksa fallso.	Përdor shumë pak shprehje të fytyrës dhe gjestet. Nuk arrin të zgjojë aq interesim lidhur me temën që prezanton.

3.3 Informatat kthyese

Kontrollimi dhe vlerësimi i të arriturave të nxënësve mund të kuptohet si një lloj i dialogut ndërmjet mësime dhe nxënës për cilësinë e të nxënës, mësime dhe të arriturave në përgjithësi. Ky komunikim i dyanshëm siguron informata kthyese, të cilat e mundësojnë identifikimin e vështirësive me të cilat ballafaqohen nxënës gjatë procesit të nxënies, por njëkohësisht, kjo informatë siguron zbulimin e shkaqeve të cilat i sjellin ato vështirësi. Informatat kthyese janë një pjesë shumë e rëndësishme e të nxënës. Ato janë mekanizma që i *lejojnë nxënës ta dinë nëse ata janë në rrugën e duhur*. Informatat kthyese janë reagime për rezultatet e një procesi apo aktiviteti.



Mësime duke i dhënë informatë kthyese nxënës me qëllim të përmirësimit.

Në Vlerësimin për Nxënie, detyra të duhura janë ato që sigurojnë informacion me theks tek procesi e jo vetëm tek përgjigja e saktë.

Kur jepen informatat kthyese?

- **derisa nxënës e kryejnë një detyrë të caktuar;**
- **derisa nxënës e prezantojnë detyrën;**
- **pas përfundimit të detyrës**

*Hulumtimet tregojnë se nxënës mësojnë me vështirësi kur ata janë të shqetësuar. Është e rëndësishme që mësime të marrë parasysh gjendjen emocionale të fëmijës gjatë dhënies së informatave kthyese, në mënyrë që ato të kenë efekte **pozitive**.*

Informata kthyese është efektive kur jepet në kohën e duhur – atëherë kur është e domosdoshme për nxënës.

Informata kthyese që jepet nga mësimdhënësi duhet:

- të jetë **përshkruese**
- të jetë e **saktë** dhe e **fokusuar**
- të jetë **specifike** e jo e përgjithësuar
- të jetë e **matur**
- të jetë e **individualizuar** dhe me orientim pozitiv për nxënësin
- t'i japë mundësi nxënësit të **reagojë**

Si jepen informatat kthyese?

- me gojë /verbale;
- me shkrim;
- me gjestikulacion/shprehje ...

Kur informatat kthyese jepen me gojë, ato duhet të jenë pozitive – ta pranojnë punën e bërë nga nxënësi dhe rezultatet e arritura; duhet të jenë zhvilluese – të ofrojnë orientim konkret për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Informatat kthyese duhen të jepen kundrejt kritereve të suksesit dhe qëllimit të të nxënit.

Informatat kthyese mund të jepen edhe me anë të rubrikave. Rubrikat janë mjete shumë të mira që i ndihmojnë nxënësit të mësojnë nga gabimet e veta dhe t'i vlerësojnë njohuritë, shkathtësit apo punën e tyre.

Shembuj:

Mësimdhënësi i Edukatës fizike, pas regjistrimeve të aktiviteteve të nxënësve i diskuton ato me të gjithë nxënësit, dhe u jep informata kthyese secilit veç e veç në mënyrë që në përpjekjet e tyre të rradhës ta përmirësojnë performancën e tyre.

Kërcimi i kaluçit këmbëhapur



'Leonita në pozicionin që ndodhet në foto shihet se i ka realizuar mjaft mirë të gjitha fazat e kërcimit (vrulli, shtytja mbi pedanë, mbështetja, kalimi, dhe rënia). Këmbët i ka të hapura mirë (këmbën e djathtë e ka shumë pak të lakuar në artikulationin e gjurit, dhe shputën e këmbës së djathtë duhet ta ketë më të shtrirë në maje të gishtërinjëve), trangu mirë, koka mirë me shiqim para (vërejtje për mënyren e kapjes së flokëve pasi që pengojnë pamjen), duart mirë përveq dorës së djathtë e cila është e lakuar në artikulationin e bërrylit'

' Shfrytëzimi i fotoapararit (për ushtrime statike) dhe Flip kamerës (për ushtrime dinamike) është shumë efektive për VpN. Unë bashkë me nxënësit kemi mundësi t'i analizojmë performancat e të gjithëve dhe të japim informata kthyesë, me qëllim të përmirësimit në paraqitjet tjera '


Iliri, mësues

Informatat kthyesë gojore shfrytëzohen për qëllime të ndryshme:

- **Korrigjim i gabimit**
- **Parashtrim i një sfide**
- **Vlerësim, lavdërim**
- **Sqarim plotësues**
- **Orientim i të nxënit dhe aktivitetit**
- **Verifikim dhe vazhdim i të nxënit**
- **Sqarim i hapave të mëtejme**
- **Nxitje e reflektimit**
- **Fokusim në strategjitë e të nxënit...**


Shembuj të informatave kthyesë me shkrim:

Informatat kthyesë mësuesi i shënon me dy ngjyra. Me ngjyrë të kaltër lavdëron punën e nxënësit, kurse me të kuqe i shënon 'gabimet' në mënyrë që nxënësi t'i përmirësojë ato.





Me nxënës të moshave të vogla, informatat kthyes mund të jepen edhe me shënimet 'Plus-minus-!' apo me kodimet me ngjyra. Është mirë t'i shmangemi informatave kthyes që janë gjyquese dhe lavdëruese dhe të përdorim sa më shumë informata kthyes efektive që ndihmojnë përmirësimin e të nxënës.



Informata kthyes joefektive	Informata kthyes efektive
'Punë e mirë'	'Në paragrafin e parë keni bërë lidhje shumë të mirë me temën. Kujdesuni që së paku tri detaje nga teksti ta mbështesin idenë tuaj'
'Shumë bukur'	
'Bëje më mirë'	
'Duhet më shumë përpjekje'	'Konstruktivi juaj është i mirë, por kujdes kur fshini me gomë'

Informatat kthyes me shkrim mund të jepen me anë të notës; me anë të notës dhe komentit; si dhe vetëm me anë të komentit. Studimet e shumta tregojnë se informatat kthyes kur jepen vetëm me koment kanë efektin më të madh drejt përmirësimit dhe ngjitjes së suksesit të nxënës.

Informata kthye e përcjellur me notë nuk ka efekt në përmirësim, pasi që nxënësi e shikon vetëm notën dhe injoron komentin dhe bën krahasimin me notën e shokut/shoqes që ka afër dhe nuk i jep rëndësi komentit. Mirëpo nëse informatat kthye jepen vetëm me koment atëherë nxënësi do të përqëndrohet në përmbajtjen e komentit dhe do të punojë drejt përmirësimit. Hulumtimet tregojnë (Black & William, 1998), se kur informatat kthye jepen vetëm me koment ka përmirësim të suksesit të nxënësve:

- **Vlerësimi me notë, nuk ka përmirësim në sukses**
- **Vlerësimi me komente dhe notë, nuk ka përmirësim**
- **Vlerësimi vetëm me komente, përmirësim deri në 30%**

Gjithsesi, nuk është e nevojshme që gjithmonë të përdoret informata kthye vetëm me koment, mirëpo kjo është një strategji e VpN-së e cila duhet të promovohet gradualisht me qëllim të përmirësimit të procesit mësimor. Pra, jo vetëm kjo strategji por të gjitha strategjitë e VpN-së duhet të prezantohen në klasë në mënyrë graduale deri sa të adaptohen edhe mësimdhënësit edhe, nxënësit si dhe prindërit. Mësimdhënësi, fillimisht mund të caktojë një herë në muaj t'i vlerësojë nxënësit vetëm me koment, dhe më vonë shkon duke e përdorur më shpesh këtë strategji.

Hulumtimet tregojnë se të jesh i motivuar dhe të kesh vetëbesim, janë çelësi i suksesit të nxënësit. Megjithatë, informatat kthye përveç 'pozitivizmit' duhet t'i tregojnë edhe gabimet (në mënyrë që ato të përmirësohen).



Nxënësja duke i dhënë informatë kthye shokut të klasës.

3.4. Vlerësimi i ndërsjellë (njëri-tjetri)

Hulumtimet tregojnë se **vlerësimi i ndërsjellë** është mjaft efektiv. Derisa nxënësit vlerësojnë punën e bashkëmoshatarëve të tyre, ata mund t'i qartësojnë edhe idetë e tyre për qëllimet e të nxënësve dhe kriteret e suksesit. Ky vlerësim duhet të zbatohet me kujdes dhe të arriturat e nxënësve duhet të krahasohen me të arriturat e tyre të mëparshme e jo me të tjerët.

Rregullat që duhet ndjekur gjatë vlerësimit të ndërsjellë janë⁸:

- **Keni parasysh rëndësinë e të dëgjuarit**
- **Mos i ndërprisni të tjerët kur flasin**
- **Kërkoni sqarime, mos u nxitoni**
- **Respektoni punën e partnerit**
- **Filloni me pozitivizëm dhe inkurajim**
- **Jini të qartë si mund të përmirësohet partneri juaj**
- **Jini i ndershëm, por shmangni kritikën e tepërt**
- **Bëhuni i drejtë dhe respektoni besueshmërinë**

Teknika për vlerësimin e ndërsjellë:

1. Takime të shkurtra për ta përmirësuar të shkruarit

E përshtatshme për lëndët ku nxënësit bëjnë punime të shkruara (gjuhë, histori, etj.). Tek esetë, në takimet e shpejta gjysma e klasës qëndron e ulur në bankë. Gjysma tjetër lëvizë nga banka në bankë çdo 5 minuta. Kështu, çdo nxënës takon një partner tjetër çdo 5 minuta. Gjatë këtyre 5 minutave (kohës për takimet e shpejta), çdo partner lëvizës ulet pranë partnerit të ulur. Partnerët japin komente dhe informata kthyesë rreth asaj që kanë dëgjuar apo parë. Deri në fund të orës, çdo nxënës do të ketë disa këndvështrime të ndryshme rreth të gjitha pjesëve të punimit të tij.

Kjo teknikë mund t'i ndihmojë nxënësit më të dobët sepse u jep atyre mundësi që të shohin shembuj të eseve më të avancuara. Nxënësit tjerë, fillojnë të mendojnë se si të ndërhyjnë dhe ta përmirësojnë punën e tyre edhe më shumë. (Smith, 2008).




Nxënësjka duke vlerësuar punën e shoqes me teknikën "takime të shkurtra për ta përmirësuar të shkruarit"

⁸ Këto rregulla duhet t'i tregohen dhe shpjegohen nxënësve para çdo vlerësimi të ndërsjellë.

2. Dy yje dhe një dëshirë – siguron një strukturë zhvillimore pozitive që i ndihmon nxënësit të vlerësojnë dhe të raportojnë për punën e njëri-tjetrit.

- Nxënësit pas punës individuale, i shkëmbejnë detyrat e tyre dhe reflektojnë për punën e tjetrit;
- ‘Kontrolluesi’ (nxënësi kontrollues) identifikon dy elemente/ide pozitive (yje) në detyrën e shokut/shoqes, dhe një aspekt tjetër të punës/detyrës ku ka nevojë për përmirësim apo zhvillim të mëtutjeshëm (dëshirë).
- Mund të ketë një yll (apo më shumë se dy yje), apo nxënësi mund të jetë i kënaqur me detyrën dhe nuk ka vend për asnjë dëshirë.
- Komunikimi i yjeve dhe dëshirave mund të jetë në formë të shkruar, me gojë apo në forma tjera (vizatime, imazhe..)

Vërejtje: Kjo teknikë mund të përdoret edhe nga vetë mësuesi, kur u jep nxënësve informata kthyesë për punën e bërë, apo edhe si vetëvlerësim, kur nxënësi e vlerëson punën e tij.



Vlerësimi i mësuesit me teknikën “Dy yje një dëshirë”

3. Kontrollimi para fluturimit⁹ – është një teknikë që siguron që puna e dërguar për kontrollim tek mësimdhënësi i përmbush të paktën standardet minimale të ndërlidhura me kriteret e suksesit.

- Nxënësit e shkëmbejnë punën/detyrën me njëri-tjetrin dhe ata e krahasojnë detyrën e shokut/shoqes me listën e kriterëve të paraqitura për të gjithë nxënësit;
- Nxënësi-kontrollues duhet të sigurohet se janë përfshirë elementet themelore në punën e shokut/shoqes;
- Kontrolluesi nuk gjykon për punën e shokut/shoqes, por i raporton atij/asaj se çfarë është harruar dhe çfarë duhet të përfshihet;
- Nxënësi – autori i përmirëson gabimet para se ta dorëzojë detyrën e tij.



Nxënësit duke vlerësuar punën e shokëve dhe shoqeve të klasës me teknikën ‘Kontrollimi para fluturimit’

⁹ Pilotët përdorin teknikën ‘Kontrollimi para fluturimit’ për t’u siguruar se gjithçka është gati dhe në rregull para se ta fluturojnë aeroplanin.

3.5.Vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi është 'mjet' i rëndësishëm për Vlerësimin për Nxënie – VpN. Kur nxënësi vlerëson njohuritë e tij momentale, lëshimet dhe gabimet gjatë të nxënës, ai fiton ide më të qarta se si t'i ndihmojë vetes për t'u përmirësuar.

Gjatë procesit të vetëvlerësimit, nxënësit duhet të dinë:

- *Ta analizojnë punën e tyre*
- *Të kërkojnë mbështetje kur pranojnë se hasin në probleme gjatë punës së tyre (pa ndikim në vetëbesimin e tyre)*
- *Ta shfrytëzojnë kohën e mjaftueshme për t'i përmirësuar detyrat/problemet e pazgjidhura*

Teknika për vetëvlerësimin

1. **Ngjyrat e semaforit** është një teknikë shumë efektive që ia mundëson nxënësit të reflektojnë për veten e tij nëse ka kuptuar ose jo një çështje/detyrë apo temë të caktuar. Në të njëjtën kohë i komunikohet mesimdhënësit të kuptuarit ose jo për secilin nxënësi në mënyrë individuale.
 - *Nxënësit i mbajnë tri letra (kartona) me ngjyra të ndryshme para vetes të cilat pasqyrojnë: e gjelbëra – e kam kuptuar, e verdha – nuk jam i sigurt dhe e kuqja – nuk e kam kuptuar; Ata e ngrisin lartë njërin prej letrave kur u kërkohet nga mesimdhënësi;*
 - *Kjo teknikë përdoret në faza të ndryshme të orës, e jo vetëm në fund të saj;*
 - *Kur mesimdhënësi e merr informatën kthyesë nga nxënësit është më i sigurt në planifikimin e aktiviteteve tjera shtesë për ata që nuk kanë kuptuar (ose u kërkohet të bashkëpunojnë me nxënësit që e kanë të qartë/e kanë kuptuar detyrën);*
 - *Në vend të letrave (kartonave) me ngjyra mund të përdoren edhe shenja tjera (si fytyra të buzëqeshura/të pikëlluara! ose numrat 3,2,1):*

Shënime:

3	<i>Kam kuptuar shumë mirë dhe mund t'ju shpjegoj të tjerëve</i>
2	<i>Kam kuptuar, por më duhen edhe disa sqarime</i>
1	<i>Nuk kam kuptuar dhe kam nevojë për sqarime</i>



Nxënësit vlerësojnë vetën me teknikën “Ngjyrat e semaforit”.

2. **Di/dua të di/mësova (D/D/M)** është një teknikë që mundëson një vetëkontroll të të nxënësve dhe të kuptuarit. Në fillim të orës, mësuesi vizaton një tabelë me tri kolona:

- Fillimisht u kërkohet nxënësve të vendosin në listë, në kolonën e parë, gjithë çfarë dinë për një temë të caktuar dhe në kolonën e dytë çfarë ata dëshirojnë të dinë më shumë;
- Merret informacioni për temën (nga teksti, shpjegimi i mësuesit, nga video apo ndonjë mënyrë tjetër);
- Analizohet informacioni dhe krahasohet me pyetjet e ngritura.
- Në fund, nxënësit shkruajnë çfarë kanë mësuar.
- Mësuesi i diskuton bashkë me nxënësit përgjigjet, jep sqarime tjera për gjërat jo të qarta, dhe planifikon hapat e ardhshëm për mësim.



Nxënësit e klasës së nëntë duke përdorur teknikën "Di/Dua të di/Mësova" në lëndën e edukatës qytetare.

Vetëvlerësimi

	E gjelbërt	E verdhë	E kuqe
Nxirni dhe shkruani përmbajtjen e tekstit	Kam nxjerrur dhe shkruar shumicën e përmbajtjes së tekstit.	Kam nxjerrur dhe shkruar vetëm një pjesë të tekstit.	Kam shkruar shumë pak nga përmbajtja e tekstit.
Vizato një skenë që mund t'i përshtatet tekstit	Kam vizatuar skenë, e cila i përshtatet tekstit.	Kam vizatuar një skenë që përshtatet deri diku me tekstin.	Kam paraqitur vetëm një vizatim.
Emëro personazhet në tekst	Emëroj të gjithë personazhet në tekst.	Emëroj personazhet e tekstit por më ngatërrohen.	Përveç njërit të tjera personazhe s'mund t'i emëroj.

Vetëvlerësim i një nxënësi të klasës së tretë me anë të rubrikës.

3. Krijimi dhe përdorimi i rubrikave të pikëve

- Hapi i parë: nxënësit përfundojnë një detyrë si p.sh. bërja e një punimi artistik apo përfundimi i një projekti;
- Mësimdhënësi dhe nxënësit krijojnë së bashku një rubrikë pikësh;
- Nxënësit punojnë në grupe ose në çifte për ta përdorur rubrikën e pikëve për detyrën e përfunduar;
- Nxënësit i raportojnë klasës se çfarë kanë mësuar nga përdorimi i rubrikës.

Shënime:

Si mund ta di nëse kam punuar mirë?

???

Çfarë mund të mbaj mend dhe të kuptoj?



Cilat janë anët e mia të forta dhe ato më të dobëta?

!!!

Si po më shkon?



Çfarë më bënë të mendoj?

???

Cilat janë qëllimet e mia?

???

Çfarë më duhet të bëjë për t'u përmirësuar?



Ku duhet ta fokusoj rishikimin tim?

A jam duke mësuar në mënyrën e duhur?

4. Shfrytëzimi i dosjes (portfolios) për Vlerësimin për Nxënie

Ç'është dosja (portfolio)?

... një 'koleksion' i qëllimshëm i punimeve të nxënësit që tregon për përpjekjet, përparimin dhe të arriturat e tij në një fushë mësimore të caktuar. Ky 'koleksion' duhet të përfshijë pjesëmarrjen e nxënësit në përzgjedhjen e përmbajtjes së dosjes (portfolios), udhëzimet për përzgjedhje dhe kriterin e vlerësimit për të dëshmuar meritat dhe dëshmitë e vetë-reflektimit të nxënësit.

Arter&Spandel, 1992 (32)

... përbëhet prej 'pjesëve të provave'. Sa më shumë prova të përshtatshme, nxjerrja e përfundimeve për nivelin e arritshmërisë së nxënësit në një fushë mësimore është më e vlefshme'

Forster & Masters, 1996 (2)

Pse është e rëndësishme të shfrytëzohet dosja (portfolio) për VpN?

- Paraqet një portret të saktë dhe të përmbledhur të nxënësit;
- Përfshin nxënësin në marrjen e vendimeve për zgjedhjen e punës së tij më cilësore;
- Mundëson që nxënësit t'i shfaqin 'ndryshimet' p.sh. inteligjencat e shumëfishta, diversitetin kulturor, etj;
- Tregon ngritjen e nxënësve të bazuar në reflektimet e tyre - përparimin dhe pengesat gjatë të nxënit ;
- Përmirëson mësimdhënien duke integruar vlerësimin për nxënie;
- Ngrit përgjegjësinë e nxënësit për vetëvlerësim.

Çfarë sugjerime duhen për të shfrytëzuar dosjen (portfolion)?

- *Vendosni për qëllimet e dosjes (portfolios);*
- *Caktoni rezultatet e pritura dhe si mund të shfrytëzohet dosja (portfolio) për t'i paraqitur ato;*
- *Krijoni mundësitë që në bashkëpunim me nxënësit ta caktoni përmbajtjen e dosjes (portfolios);*
- ***Jepni kohë nxënësve të reflektojnë dhe të angazhohen në vetëvlerësim***

3.6 Përdorimi i strategjive efektive të parashtrimit të pyetjeve

Pyetjet dhe niveli i pyetjeve të parashtruara i shërbejnë jo vetëm Vlerësimin për nxënie, por ato janë shumë të rëndësishme edhe në kontekst të Vlerësimin të Nxënies – *notimit*. Edhe hulumtimet e ndryshme tregojnë se:

- *Mësimdhënësit mund të parashtrojnë mesatarisht nga një pyetje, madje edhe nga dy pyetje në minut, që do të thotë se rreth njëqind në ditë ose dhjetëra mijëra pyetje gjatë një viti shkollor (Wragg, 1997);*
- *Nxënësit mësojnë më shumë kur mësimdhënësit parashtrojnë pyetje më shpesh gjatë përcjelljes së përparimit dhe kontrollimit të të kuptuarit (Harris, 1998);*
- *Parashtrimi i pyetjeve 'paraqet faktorin më të rëndësishëm individual që nxënësit të arrijnë standarde të larta, kur pyetjet përdoren që të vlerësohen njohuritë e nxënësve dhe të sfidohet të menduarit e tyre' (Ofstend, 1996).*

Parashtrimi i pyetjeve që kërkojnë të menduarit e niveleve të ndryshme¹⁰ përdoren si instrumente për Vlerësimin për Nxënie. Në këtë rast mësimdhënësit:

- ***Shfrytëzojnë pyetjet për të kuptuar se çka dinë nxënësit, çka kuptojnë dhe çfarë mund të bëjnë ata;***
- ***Analizojnë përgjigjet për të kuptuar se çka dinë nxënësit, çka kuptojnë dhe çfarë mund të bëjnë ata;***
- ***Shfrytëzojnë pyetjet për të kuptuar se çfarë ide të gabuara kanë nxënësit me qëllim të orientimit të drejtë të të nxënësve të tyre efektiv;***
- ***Shfrytëzojnë përgjigjet e nxënësve që ta përmirësojnë si mësimdhënësin ashtu edhe të nxënësve.***

Shembull:

1. Mësimdhënësi dëshiron ta dijë nëse nxënësit e tij i dinë veçoritë e numrave të thjeshtë. Nëse në pyetjen: "A është numri 7 numër i thjeshtë?", ai merr përgjigje 'Po', kjo nuk i mundëson atij të vlerësojë saktë nëse nxënësi ka vërtetë njohuri për numrat e thjeshtë dhe veçoritë e tyre (se ata kanë vetëm dy pjestues, numrin 1 dhe vetveten).
2. Edhe në pyetjen 'Kush e shkroi romanin 'Prilli i thyer'?', mësimdhënësi mund të kuptojë pak apo aspak nëse nxënësi ka njohuri për stilin e të shkruarit në atë roman apo për veprimtarinë e shkrimtarit.

¹⁰ Musai B. : Metodologji e mësimdhënies, Tiranë, 2003;

Do të ishte shumë e dobishme nëse pyetjet do të orientoheshin kah kontrollimi i përvetësimit të qëllimeve mësimore në nivel më të lartë. Kjo do të bëhet lehtë nëse pyetjet, në vend që të kërkojnë përgjigje për diçka që tani më është e sqaruar në tekst ose nga vetë mësimdhënësi, të kërkojnë njohuri që do të ndërliken me informatat e ofruara ose informatat e ofruara paraprakisht (Linn & Miller, 2005)

Pyetjet dhe llojet e tyre

Pyetjet dhe teknikat e të pyeturit kanë vlera të shumëfishta. Për të nxitur të menduarit e nxënësve është e rëndësishme të konsiderojmë nivelin e pyetjeve që bënë mësimdhënësi. Në qoftë se pyetjet janë të gjitha të nivelit të njohjes, atëherë të menduarit ndodhë pak ose aspak. Të përsëriturit mekanik, riprodhues, është i nevojshëm për termat e reja që mësohen, për rregullat, formulat apo për të dhënë shpjegime të ndryshme, por jo edhe për të nxitur të menduarit e nivelit të lartë. Pyetjet e nivelit të lartë që zakonisht fillojnë me “Si...?”, “Pse...?” dhe “Çfarë...?” janë pyetje që kërkojnë nga nxënësit të mendojnë dhe të reflektojnë për atë që kanë mësuar.

Parashtrimi i pyetjeve sipas niveleve të ndryshme të të menduarit – Taksonomia e Bloom-it-¹¹ shembuj:

- **Njohja** – Si quhet...? Kur ka ndodhur...? Cilat janë llojet e ...? Kush e ka shkruar romanin?
- **Të kuptuarit** – Shpjego situatën e zhvilluar në ...; Cilat janë karakteristikat themelore të ...?; Çfarë mund të thoni për?;
- **Zbatimi** - Çfarë ndodh pas përdorimit të ...? A mund të përdoret Teorema e Pitagorës për zgjidhjen e problemit ...? Paraqitni grafikisht;
- **Analiza** – Cili është funksioni i ...? Çfarë rregulla zbatohen me rastin e zgjedhimit të foljeve? Çfarë roli luannë ...?
- **Sinteza** – Cilat përfundime mund t’i nxjerrni nga? Cila është ideja kryesore e shkrimtarit ?
- **Vlerësimi** – Cila strategji ishte më e mirë për t’u zbatuar? A mendoni seështë më e përshtatshme se sa? Arsyetoni, pse?

Sipas funksionit që kanë, pyetjet mund të jenë:

1. **Pyetje të mbyllura** - për të vlerësuar njohuritë apo të kuptuarit e nxënësve për materialet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose për të paraqitur tema për diskutim; Kur është hapur shkolla e parë shqipe?
2. **Pyetje të hapura** - që u kërkojnë nxënësve të përdorin, lidhin apo zbatojnë ide, japin arsye, përmbledhin apo vlerësojnë dhe shpesh përfshijnë përgjigje të zgjeruara, që u mundësojnë atyre të paraqesin të kuptuarit më të thellë; Çfarë rëndësie ka për ju zbulimi i rrjetit pa tela?
3. **Pyetje nxitëse** - për t’i inkurajuar ose drejtuar përgjigjet e nxënësve tek aspektet specifike të të nxënësve; Si mund ta zhvillojë një grafik ose tabelë që organizon këtë informacion në një mënyrë të dobishme?

¹¹ Po aty.

- 4. Pyetje që përdoren për shkëmbime të zgjeruara** - përfshijnë pyetje të shumta që rrjedhin ndaj përgjigjeve fillestare të nxënësve me qëllim të nxitjes së të menduarit të nivelit të lartë; A mund të shfrytëzoni këto parime në një situatë të jetës së përditshme?
- 5. Pyetje që kërkojnë përgjigje të menjëhershme dhe specifike** - përdoren për të nxitur të nxënët e mëtejshëm; Si mund të shfrytëzoni këtë koncept në problemin e ri?

Shembuj: Shembuj të ndryshëm për të pyeturit:

1. Pyetjet që bëjnë vetë nxënësit

- Jepni nxënësve ta lexojnë një tekst ose ta dëgjojnë një prezantim nga mësimdhënësi;
- Ndajeni grupin në dysh;
- Kërkoni nga secili nxënës të shkruajë 4 pyetje që kanë të bëjnë me mësimin.
- Kërkoni nga nxënësit t'i përgjigjen pyetjeve të njëri-tjetrit.
- Diskutoni se çfarë e bën një pyetje të lehtë ose të vështirë.
- Më pas kërkoni nga nxënësit që të sugjerojnë mënyra se si t'i përmirësojnë pyetjet e tyre.

'Më pëlqen kur kemi pyetje si kjo, pyetje që më bëjnë të mendoj dhe për të cilat duhet dhënë shpjegim'

Nxënëse dhjetë vjeçare



Nxënësi duke përgatitur dhe parashtruar pyetje njëri-tjetrit.

2. Identifikimi i pyetjeve të kategorive të ndryshme

- Pyetni nxënësit se çfarë e bën një pyetje të lehtë apo të vështirë;
- Jepni nxënësve disa pyetje të bazuara në një tekst ose prezantim që e keni bërë;
- Kërkoni nga nxënësit t'i rradhisin pyetjet si: e lehtë ose e vështirë; apo (shumë e lehtë, paksa e lehtë, mjaft e vështirë, shumë e vështirë)
- Kërkoni nga nxënësit ta arsyetojnë rradhitjen (d.m.th., të shpjegojnë pse disa pyetje i kanë rradhitur si të lehta, e të tjerat si të vështira.)
- Ftoni ata që t'i bëjnë ndryshimet e pyetjeve për t'i përmirësuar ato

3. Personale/E Ndërsjellë/Publike (PNP)

Kjo është një qasje e parashtrimit të pyetjeve për ata nxënës që janë të dekurajuar për të dhënë përgjigje para tërë klasës. Mësimdhënësi parashtron pyetjen (me gojë ose me shkrim) dhe vazhdohet me tri faza:

Faza 1. Personale – nxënësit në mënyrë të pavarur i shkruajnë përgjigjet për pyetjen/et e parashtruara

Faza 2. E ndërsjellë – nxënësit i krahasojnë përgjigjet me shokun/shoqen afër apo me një grup të vogël nxënësish;

Faza 3. Publike – nxënësit ftohen t'i japin përgjigjet e tyre para klasës, të cilat vlerësohen nga njëri –tjetri.



Vlerësimi për nxënie duhet të jetë plotësisht i integruar në programin mësimor

Teknika efektive për pyetje

Teknika	Përfitimet
<ul style="list-style-type: none"> Lejo kohën e duhur për të menduar nxënësi para se të përgjigjet. 	Nxit thellësin e të menduarit dhe rritë nivelin sfidues
<ul style="list-style-type: none"> 'Telefono mikun'¹² 	Inkurajon dëgjim të tërë klasës
<ul style="list-style-type: none"> 'Karriga e nxehtë'¹³ 	Inkurajon dëgjim për detaje dhe ofron sfida
<ul style="list-style-type: none"> Rishikimin e pyetjes para kohe 	Sinjalizon koncepte të mëdha dhe nxënien e mësimin
<ul style="list-style-type: none"> 'Ju nuk jeni i lejuar të përgjigjeni në këtë në më pak se 15 fjalë' 	Zhvillon aftësitë e të folurit dhe të arsyetimit
<ul style="list-style-type: none"> Vënia në skenë ose renditja e pyetjeve me rritjen e nivelit sfidues 	Thelbi i pyetjeve të qëllimshme, duke lëvizur nxënësit nga njohuria ose përvoja ekzistuese (shpesh nga njohuria e pa klasifikuar dhe e pa renditur) në të kuptuarit e organizuar, ku modelet dhe kuptimet janë themeluar/krijuar.
<ul style="list-style-type: none"> Përdorimi i rregullës 'jo duart lart' 	Përmirëson angazhimin dhe sfidon të gjithë nxënësit të mëndojnë.
<ul style="list-style-type: none"> Dhënia e sinjalit të nxënësve në lidhje me llojin e përgjigjes që do të përshtatet më së miri me pyetjen e kërkuar 	Ndihmon nxënësit të njohin vargun e përgjigjeve të mundshme dhe për të zgjedhur në mënyrë të përshtatshme

Grackat e pyetjeve

Është lehtë të biesh në grackë kur:

- të pyesësh shumë pyetje të mbyllura/shkurtra;
- pyetjes së nxënësve pyetje të cilat mund të përgjigjen me një përgjigje të thjesht po ose jo;
- pyetjeve më përgjigje shumë të shkurtë, pyetjeve të bazuara në kujtesë;
- pyetjes fals 'qëlloja çfarë po mendoj';
- fillimit të të gjitha pyetjeve më të njëjtin burim/prejardhje;
- përqendrimit në një numër të vogël të nxënësve dhe jo përfshirjen e tërë klasës;
- bërjes së renditjes së pyetjeve shumë të ashpëra;
- mos dhënies nxënësve kohë për reflektim/mendim, ose të parashtrajnë pyetjet e tyre;
- të pyesësh kur një tjetër strategji mund të jetë më e përshtatshme.

12 Si në "Kush do të bëhet Milioner?".

13 Nxënësit punojnë në çifte ose në grupe. Njëri e merr rolin (p.sh. një karakter në një libër) dhe pyetet nga të tjerët për biografitë e tyre, sjelljet dhe motivimet. Teknika është e dobishme për përshkrimin e një karakteri dhe zhvillimin e aftësive të pyetjeve. Nxënësi duke e luajtur karakterin ulet në një karrige përballë grupit (të radhitur në gjysmë-rrethi). Është më rëndësi që pjesa tjetër e grupit të jenë të përgatitur të bëjnë pyetje përkatëse dhe është e dobishme nëse mësimdhënësi vepron si lehtësues (fasilitatorë apo trajner) që t'i drejtoj pyetjet në drejtim konstruktiv. Nëse karakteri është i njohur, nxënësit mund të mos ju duhet shumë përgatitje.



Meow

* Pet-friendly
* Pet is your best friend
* Pet is your best friend
* Pet is your best friend

...doubt auf her
...amher neße
...Pet-ist
...Pet-ist
...Pet-ist

...sit on a
...and
...for

...and
...and
...and

...and
...and
...and

...and
...and
...and

...and
...and
...and

...and
...and
...and

...and
...and
...and

...and
...and
...and

...and
...and
...and

...and
...and
...and

4. Vlerësimi si komponentë e planifikimit të mësimit

Në planet e mësimit, mësimpldhënësi/ja duhet të marrë parasysh karakteristikat themelore të Vlerësimit për të nxënit; ndarjen e qëllimeve të të nxënit me nxënësit, kriteret e suksesit, përdorimin e teknikave efektive për parashtrimin e pyetjeve, vëzhgimin dhe teknikat për dhënie të informatës kthyesë, vetë-vlerësimin dhe vlerësimin e ndërsjellë (nga njëri-tjetri).

4.1. Planifikimi i orës mësimore dhe integrimi i VpN-së

Çelësi i suksesit të mësimpldhënies dhe të nxënit është planifikimi me kujdes dhe i strukturuar i orës mësimore, planet e mësimit nga mësimpldhënësit për ta ndihmuar strukturimin e të nxënit për vetëveten dhe për nxënësit.

Procesi i një planifikimi të mirëfilltë përbëhet nga këto tërësi: **Së pari**, përcaktimi i përmbajtjes programore, pra, çfarë duhet të mësojë nxënësi?; çfarë mund të bëjë ai për t'i përmbushur kërkesat e aktiviteteve të të nxënit? **Së dyti**, përcaktohet se çfarë di fillimisht nxënësi para se të fillojë mësimit i planifikuar për orën mësimore. **Së treti**, përcaktohet mënyra për t'i ndihmuar nxënësit për të nxënë; **Së katërti**, përcaktohen mënyrat për t'i vlerësuar rezultatet e të nxënit të nxënësve.

Hapi i parë: (Vlerësimi në fillim të mësimit)

- **Çfarë do të arrihet? Çfarë janë në gjendje të bëjnë nxënësit?**
- **Cilat janë paranojhoritë e nxënësit?**
- **Në ç'mënyrë lidhet të nxënit me përvojat dhe interesin e nxënësve?**


Hapi i dytë: (Vlerësimi gjatë mësimit)

- **Si do të vlerësoni nëse nxënësi përparon në mësimet?**
- **Si i përshtatet mësimpldhënia nxënësve?**
- **Cilat janë strategjitë, procedurat, metodat apo teknikat e vlerësimit?**

Hapi i tretë: (Vlerësimi pas mësimit)

- **Cilat njohuri të reja i ka marrë nxënësi?**
- **Si do të vlerësohet efikasiteti i mësimit?**
- **Si do të informohen prindërit dhe të gjithë të interesuarit për të arriturat e nxënësve?**
- **Si do të bëhet rishikimi i procesit?**

Vlerësimi për nxënie duhet të jetë plotësisht i integruar në programin mësimor.



Pas çdo planifikimi, mësime dhënësi ia adreson vetes pyetjet:

- *A është i përshtatshëm plani mësimor për nxënës me aftësi të ndryshme?*
- *A e nxit plani i mësimi përfshirjen e vazhdueshme të nxënësve në aktivitetet e të nxënësve dhe në vlerësimin e të nxënësve të tyre?*
- *A parashikon plani mësimor trajtim të mjaftueshëm të përmbajtjes që do të mësohet nga të gjithë nxënësit?*
- *A mundëson plani mësimor kontrollin e përparimit të nxënësve?*
- *A sigurohet ndihmë e përshtatshme për nxënësit që nuk kanë sukses me procedurat fillestare?*
- *A sigurohet zbatim i praktikave të vlerësimit që forcojnë dhe integrojnë të nxënësve dhe motivimin e nxënësve?*
- *A siguron plani mësimor se përgjegjësitë janë të ndara në mënyrë të barabartë në mes të djemve dhe vajzave?*

Rezultatet e pritshme mësimore të kurrikulës duhet të jenë bazë e të gjitha vlerësimeve.

Shënime:

4.2. Rezultatet e të nxënit dhe vlerësimi i bazuar në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës

Për t'i vlerësuar nxënësit sipas kurrikulës së bazuar në kompetenca¹⁴ është e rëndësishme që të caktohen teknika të vlerësimit që u mundësojnë nxënësve t'i demonstrojnë jo vetëm njohuritë por edhe shkathtësitë dhe qëndrimet e tyre. Për këtë qëllim, Rezultatet e të Nxënit janë faktorë kyç që mbështesin këtë vlerësim, dhe që mundësojnë një përzgjedhje efikase të teknikave për VpN dhe ViN. Qëllimet e të nxënit, objektivat e përgjithshme dhe rezultatet e të nxënit duhet të bazohen në gjashtë kompetencat e kurrikulës.

Qasja e bazuar në kompetenca supozon që gjatë definimit të rezultateve të pritura të kurrikulës dhe të procesit mësimor si dhe gjatë përzgjedhjes dhe organizimit të përvojave mësimore të integrohen në mënyrë të balancuar njohuritë parësore dhe vlerat, qëndrimet dhe shkathtësitë¹⁵.

Kështu, çdo mësimdhënës kur t'i hartojë planet mësimore (vjetore apo planin ditor) duhet t'i ketë parasysh gjashtë kompetencat e Kornizës së Kurrikulës.

Rezultatet e të nxënit janë deklarata që përshkruajnë kushte specifike dhe të matshme për atë që nxënësi do të dijë, ose do të jetë në gjendje ta bëjë si rezultat i angazhimit në aktivitetin mësimor. Rezultatet e të nxënit formojnë bazën e planifikimit të mësimit dhe planifikimit të vlerësimit.

Në mënyrë tipike shprehen si njohuri, shkathtësi, qëndrime apo kompetenca. Rezultatet e të Nxënit nga Kurrikula mund të thjeshtohen për nxënësit dhe të shkruhen si Qëllim i të Nxënit për një mësim të caktuar.

Rezultatet e të Nxënit: ***Shkruan drejtë (pa gabime) një tekst narrativ deri në një faqe për një temë të caktuar.***

Qëllimi i të Nxënit: ***Të mësojmë të shkruajmë një tekst narrativ***

Pse janë të rëndësishme rezultatet e të nxënit?

- Fokusohen në sjelljen (veprimin) e nxënësit (që duhet ndryshuar);
- Shërbejnë si udhëzues të mësimdhënies dhe nxënies;
- Identifikojnë në mënyrë specifike se çka duhet nxënë;
- Përcjellin tek nxënësit saktësisht atë se çfarë duhet arritur.

Një rezultat i të nxënit është i mirë nëse mund të vlerësohet veprimi i nxënësit

¹⁴ Shih, Kornizën e Kurrikulës së Kosovës.

¹⁵ Po aty.

Foljet të cilat i zgjedhim kur shkruajmë rezultate të të nxënimit për fushën njohëse në nivele të ndryshme të Taksonomisë së Bloom-it janë dhënë në shtojcën për trajnimet e mësimdhënësve.

Rezultatet e të nxënimit të përcaktuara në kurrikulë duhet të përkufizohen nga pikëpamja e aktivitetit – d.m.th, çfarë duhet të vlerësohet dhe si mund të mblidhet informacioni. Ky përkufizim i aktivitetit duhet të jetë baza e secilit vlerësim.

Kërkesa e secilit rezultat të të nxënimit na ofron bazat për shkallëzimin e cilësisë së zotërimit të aftësisë së përshkruar në rezultatit e të nxënimit nga secili nxënës. Ajo ofron bazat për të vendosur se cili nxënës ka nevojë ta përmirësojë performancën e tij, dhe çfarë hapash duhet të ndërmerren nga mësimdhënësi.

Shih tabelën vijuese:

Rezultati i të nxënimit	Teknika e Vlerësimit	Kriteri i Shkallëzimit Performancë....				
		Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët
Nxënësi është në gjendje të:						
Lexon (V) pa gabime paragrafin e dhënë me 6 rreshta.	Performimi në klasë	Lexon me saktësi të plotë	Lexon me dy ose tri gabime	Lexon me jo më shumë se gjashtë gabime	Lexon paragrafin me 7 deri 10 gabime	Lexon me më shumë se 10 gabime

Fjalorth i nocioneve të doracakut

“Dy yje dhe një dëshirë”	Teknikë e VpN-së e cila përdoret si informatë kthyese për punën e nxënësve. ‘Dy yje...’ do të thotë dy elemente pozitive, ndërsa ‘...dhe një dëshirë’ do të thotë një këshillë për ta përmirësuar punën. Mund të paraqiten edhe tri yje apo pesë, por qëllimi është që numri i yjeve (elementeve pozitive) të jetë më i lartë se sa ai i dëshirave.
“Konteksti”	Detyra apo aktiviteti nëpërmjet të cilit realizohet qëllimi i të nxënit.
“Kontrollimi para fluturimit”	Teknikë e VpN-së e cila përdoret për Vlerësim të Ndërsjellë apo Vetëvlerësim. “Kontrollimi para fluturimit” përdoret nga pilotët të cilët i bëjnë një kontrollim teknik aeroplanit me një listë kontrolluese para se të fluturojnë.
“Kriteret e suksesit”	Strategji e Vlerësimit Formativ me anë të së cilës paraqiten standardet drejt të cilave nxënësit duhet të synojnë.
“Informata kthyese”	Strategji e Vlerësimit Formativ e cila përdoret nga ana e mësimit në mënyrë që t’i informojë nxënësit se çfarë kanë punuar mirë apo çfarë duhet të bëjnë për të punuar më mirë.
Fasilitator / Fasilitues	Lehtësues apo trajner.
Kryefasilitator	Lehtësues apo trajner për fasilitatorët shkollorë.
Fasilitator shkollor	Lehtësues apo trajner me bazë në shkollë. Fasilitatori shkollor fasiliton kurse për kolegët e vet në shkollë.
“Objektiva”	Deklaratë që përshkruan se çfarë pritet nga nxënësi të arrijë nga të nxënit.

<p>“Personale / E Ndërsjellë / Publike” (PNP)</p>	<p>Teknikë e VpN-së e cila përdoret ashtu që nxënësi para se ta thotë përgjigjen në mënyrë publike, së pari e diskuton me shokun ose shoqen dhe në fund ia thotë tërë klasës.</p>
<p>Portfolio/ Dosje</p>	<p>Koleksion i punimeve të nxënësit apo mësimeve të nxënësit që dëshmon përpjekjet , punën, përparimin dhe të arriturat në një fushë mësimore të caktuar.</p>
<p>Qëllimi i të Nxënit</p>	<p>Qëllimet e të nxënit janë deklarata të shkurtëra që përshkruajnë se çfarë duhet nxënësit të dinë, të kuptojnë apo çfarë janë në gjendje të bëjnë deri në fund të një ore mësimore.</p>
<p>Rezultatet e të Nxënit</p>	<p>Rezultatet e të Nxënit paraqesin një pasqyrë të qartë të asaj që nxënësit domosdoshmërisht duhet ta dinë, të jenë në gjendje ta shprehin dhe ta bëjnë pas përfundimit të një periudhe të caktuar.</p>
<p>Rubrika</p>	<p>Rubrikat përmbajnë një apo më shumë kriteret të suksesit dhe përshkrime të një numri të niveleve të ndryshme të performancës në lidhje me këto kriteret.</p>
<p>Vlerësim</p>	<p>Proces i vazhdueshëm dhe sistematik i cili ka për qëllim të kuptuarit dhe përmirësimit të nxënit .</p>
<p>Vlerësimi Formativ / Vlerësimi për Nxënie</p>	<p>Vlerësimi formativ (VpN) shërben për të mbledhur informata si dhe për ta korrigjuar më pas punën në secilën fazë të procesit të mësimit dhe mësimit.</p>
<p>Vlerësimi Përmbledhës / Vlerësimi i të Nxënit / Vlerësimi Sumativ</p>	<p>Vlerësimi përmbledhës/ sumativ apo Vlerësimi i të Nxënit (ViN) i referohet vlerësimeve të grumbulluara, që ndodhin zakonisht në fund të një njësie apo teme të caktuar, të cilat kanë për qëllim të masin se çfarë kanë mësuar nxënësit, apo deri në çfarë cilësie kanë mësuar, dhe për ta gjykuar performancën duke u bazuar në disa standarde.</p>

Literatura e shfrytëzuar dhe burime tjera:

Arter, J. A. & Spandel, V. (1992) 'Using Portfolios of Student Work in Instruction and Assessment', Educational Measurement: Issues and Practice, Spring, pp. 36-44.

Clarke, Sh. (2010). Active Learning through Formative Assessment. HodderEducation;

James, E. Ysseldyke & Salvia, J. (1998). Assessment. Houghton Mifflin;

Gipps, V. (1994). Towards a Theory of Educational Assessment;

Black, P., Harrison, C., Lee, C., Marshall, B., Wiliam, D. (2003). Assessment for learning. Putting it into practice, Berkshire: Open University Press;

Forster, M. & Masters, G. (1996) Portfolios, Victoria: Australian Council for Educational Research.

Linn, R. L., & Miller, M. D. (2005). Measurement and assessment in teaching (9th ed.). Upper Saddle River, NJ: Pearson Merrill Prentice Hall.

Assessment Reform Group (2002). Assessment for learning: 10 Principles. Research based principles to guide classroom practice www.assessment-reform-group.org.uk.

Wiliam, D. and Thompson, M. (2006). Integrating assessment with learning what will it take to make it work?'in Dwyer, C. (Ed). The future of assessment: Shaping Teaching and Learning. Lawrence Erlbaum Associates;

Mësimdhënia dhe mësimi në shekullin 21 – Doracak për arsimtarët e arsimit fillor; USAID – AED;

The assessment for learning Strategy, department for children, schools and family;

<http://www.education.gov.uk/publications/>

Zbatimi i standardeve të notimit të nxënësve – material për trajnim. USAID – AED;

Pedagogy and Practice: Teaching and Learning in Secondary Schools. Department of Education - www.education.gov.uk;

Korniza e kurrikulës për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm (2011)

Standardet e Vlerësimit – Udhëzues, MASHT (2011),
http://www.masht.gov.net/advCms/documents/UA_standardet.pdf

<http://www.rubistar.4teachers.org/index.php>

